

Rucksack KiTa

Alltagsintegrierte Sprach- und Familienbildung



Rucksack KiTa

(Çantë Shpine KiTa)

Material për prindërit

I përpunuar prej punishtes IKEEP të RAA/NRW dhe qytetit Recklinghausen, i mbështetur prej ministrisë për generacionet, familjet, gratë dhe integracion në NRW dhe i mbështetur prej bamirësisë Freudenberg, Weinheim.

Në bazë të programit Rucksack (Çantë Shpine) / të Stichting de Meeuw, Rotterdam.

Kontakti

Programi *Rucksack KiTa*: materiali për prindërit

Botuesi: Vëndet regionale të punës për mbështetjen e fëmive dhe të rinjve prej familjeve të imigruara (RAA).

Adresa: Bezirksregierung Arnsberg, Dezernat 37
Landesweite Koordinierungsstelle Kommunale Integrationszentren (LaKI)
Ruhrallee 1-3
44139 Dortmund
Tel.: 02931 82 5215
Email: laki@bra.nrw.de
www.kommunale-integrationszentren-nrw.de

Illustracionet: Hans van den Bergh

Kompozimi: Monika Frei-Herrmann

Redaktion: Livia Daveri

Viti i botimit: 2007

Përmbajtja

Parathënje:	4
Hyrja për prindërit: Informacione për programin <i>Rucksack</i>	6
Aktivitetet:	9
• Figura për të folur	9
• Të lexosh	10
• Të lozësh	11
Tema reth vitit:	13
• Të shikosh televizor me fëmijët	14
• Të ndjesh natyrën	17
• Të festosh festa	19
Temat kryesore:	21
• Trupi	22
• Robat	36
• Kopshti	50
• Grupi	64
• Të lozësh jashtë	75
• Lëvizja	83
• Në Shtëpi	96
• Të hash dhe të pish	108
• Familja	118
• Në rugë	130
• Kafshët	140

Parathënja

Prindër të dashur,

neve po ju pajisim me verzionin e ri të materialit për prindërit të *Rucksack KiTa*.

Në vitin 1999 punishtja IKEEP (Interkulturelle Erziehung im Elementar- und Primarbereich – Edukimi interkulturore në fushën elementare dhe primare) të Vëndeve regionale të punës për mbështetjen e fëmive dhe të rinjve prej familjeve të imigruara (RAA) në NRW adaptovi Programin “Rucksack I” që vinte nga hollanda dhe e përkthevi dhe e përpunovi atë për përdorimin në Gjermani. Anët interkulturore dhe bashkpunuese u theksuan dhe botshikimi u përshtat për kushtet në gjermani. Duke filluar 1999 programi *Rucksack KiTa* u vu në punë në qytetet me RAA, pak më vonë edhe në komunat e NRW pa RAA dhe në shumë provinca të tjera – që u shtuan vit për vit. Ndërkohë është vënë re që *Rucksack KiTa* është një program që mundet të aplikohet për një fushë të gjërë.

Mbas shtatë vjet pune me verzionin e parë “Rucksack I” kishe ardhur koha për ta përpunuar materialin dhe njëherë. Me mbështetjen financiare të ministrisë për gjenerationet, familjet, gratë dhe integrimin dhe të bamirësisë Freudenberg, Weinheim neve mundemi t’ju presantojmë verzionin e ri *Rucksack KiTa*.

Programi Rucksack KiTa mundet të përdoret me fëmijët që nga mosha 4 vjeç. Ju si prindër ju prezantohen aktivitetet gjithmonë me parimin e një mardhënjeje pozitive midis prindit dhe fëmijës që ti ndimoni fëmijët të zhvillohen mirë. Në fletat udhëzuese që shpërndahen çdo javë këto aktivitete janë vetëm në formën e fjalëve kyçe. Nëqoftse nuk jeni të sigurtë çfarë është menduar mbrapa një aktiviteti ju mundeni të lexoni në pikën “Aktivitete” pse rekomandohen këto për zhvillimin e fëmijëve.

Me ndihmën tuaj përpunohen tema, që i përshtaten jetës së përditshme dhe moshës të fëmive.

Temat përshtaten prej shoqeruesve të prindërve për kopshtin. Nëqoftse fëmijët e njohin temën në KiTa prapë, që ata diskutuan bashkë me ju në shtëpi, atëherë kjo i ndimon ata për një zhvillim të mirë dy gjuhësh. RAA i pajis kopshtet në komunat e saj me materiale plotësuese, që janë të përshtatshme me materialet e prindërve për ta paralelizuar programin *Rucksack KiTa* në gjuhën e dytë Gjermanisht. Në këtë mënyrë fëmijët tuaj mundet të ushtrohen njëkohësisht në gjuhën e tyre të parë si dhe në gjuhën e tyre të dytë Gjermanisht.

Ne i kemi vënë fushat “Të perjetosh natyrën” dhe “Të festosh festa” si tema për të gjithë vitin në materialet e prindërve. Kopshtet drejtojnë gjatë vitit me fëmijët projekte që lejojnë kohë dhe vend për të përpunuar tema që i interesojnë fëmijët në fazën e tyre individuale të zhvillimit. Fëmijët mësohen të meren me një temë që u intereson atyre për një kohë më të gjatë, të gjejnë gjithmonë ku e lanë punën herën e fundit dhe të ta vazhdojnë atje. Si prindër ju mundeni ti ndihmoni fëmijët tuaj gjatë konfrontimit të tyre me temën aktuale. Pedagogët e specializuar neve i kemi inkurajuar ti diskutojnë këto tema disa herë gjat vitit, dhe ti paralelizojnë këto me aktivitetet e tyre.

Për ju si prindër trajtimi i orëve që fëmija juaj shikon televizor është një temë e përditshme, prandajë ne kemi futur disa udhëzime në këtë drejtim në program.

Vëndi regional i punës për mbështetjen e fëmive dhe të rinjve prej familjeve të imigruara (RAA) ju uronë që të kënaqeni duke punuar me fëmijët tuaj dhe neve të shpresojmë, që këto materiale për prindërit do ju ndimojnë. Nëqoftëse na nisni vlersime, korektura dhe amendamente nga praktika do ju ishim shumë mirënjohës.

Do deshim të falenderonim të gjithë që kanë punuar për zhvillimin e materialit të prindërve *Rucksack KiTa*: San Altuntas, RAA Mönchengladbach, Rima Chati, RAA Essen, Livia Daveri, Hauptstelle RAA/NRW, Nurhan Dogruer-Rütten, RAA Bochum, Leyla Güleriyüz, Jugendamt Recklinghausen, Renate Henscheid, RAA Gelsenkirchen, Irene Kastenholz, RAA Oberhausen, Monika Kostewitz, RAA Hagen, Claudia Mai, RAA Herne, Maria Trepper, RAA Kreis Unna, Nadire Yilmazer, RAA Bielefeld, Diler Senol-Kocaman, RAA Hamm.

Dr. Monika Springer-Geldmacher, Hauptstelle RAA/NRW.



Hyrja për prindërit:

Informacione për Programin Rucksack

Në kopsht fëmija juaj e vazhdon zhvillimin e tij. Dhe në shtëpi fëmijët tuaj zhvillohen. Çdo ditë fëmija juaj mëson më shumë. Ju mundeni të kontribuoni shumë për një zhvillimin të mirë e fëmijës tuaj. Programi Rucksack do t'ju ndimojë ju në këtë pike dhe t'ju japi ide të reja.

Çfarë mundeni ju të bëni:

- Flisni me pedagogët e specializuar për fëmijën tuaj dhe për eksperiencat e tij në kopsht.
- Flisni me fëmijën tuaj për eksperiencat e tij.
- Mundohuni të këndoni më fëmijën tuaj këngët e shënuara.
- Lëreni fëmijën tuaj të vishet dhe të xhvishet vetë aq shpesh sa mundet, se këtë ai duhet ta bëjë dhe në kopsht.

Ky program i kushton gjuhës shumë vëmëndje. Detyrat e këtij programi ndjekin qellimin të ndimojnë zhvillimin e gjuhëve të fëmijës tuaj. Nëqoftse fëmija juaj bën përmirsim në gjuhë, atëherë ai mundet ta bëjë veten e tij më të kuptueshëm. Ndoshta ju dëgjoni shpesh argumentin që të flisni Gjermanisht me fëmijën tuaj. Ky program ju inkurajon të flisni me fëmijët tuaj në gjuhën që ju e dini më mirë. Në gjuhën në të cilën ju ndiheni më të sigurt, ju do krijoni një mardhënjë të mirë me fëmijën tuaj. Ju do mundeni të flisni rjedhshëm me fëmijën tuaj pa pasur nevojë për të kërkuar fjalët. Në gjuhën që dini më mirë mundeni ti sprehni ndjenjat tuaja kundra fëmijës më saktë. Një mardhënjë e mirë, një e folur e rjedhshme do e ndimojë fëmijën tuaj të zhvillohet mirë. Dhe aftësia juaj për të folur do përmirsohet gjatë kësaj.

Vini re si fëmija juaj loz edhe si sillet me fëmijët e tjerë. Përgjigjuni fëmijës tuaj për pyetjet që ai ka dhe komentet që ai thotë. Gjejeni kohën të diskutoni me fëmijën tuaj për një gjë të caktuar për të cilën ai interesohet. Ky vëzhgim do ju ndihmojë të kuptoni nevojat e fëmijës tuaj, ti mbulloni ato më mirë dhe ta ndimoni fëmijën tuaj më mirë në zhvillimin e tij.

Detyra që ju jepen shpesh herë në këtë program janë:

- Lexoni një libër me fëmijën tuaj.
- Flisni me fëmijën tuaj për kopshtin.
- Vizatoni bashkë diçka.
- Lozni bashkë një lojë, për shëmbul lojën “Memory”, ose një “Kimspiel”.

Për këto detyra do merni informacione prej shoquerses tuaj të prindërve.

Pse merni pjesë në këtë program?

Shumë fëmijë që riten me dy gjuhë kanë probleme me njëren prej atyre, disa edhe me të dyja.

Ju si prindër keni një rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjuhëve të fëmijës tuaj. Programi *RUCKSACK* është një mjet ndime për ju.

Si punohet me *RUCKSACK*?

Shoqeruesja e prindërve ju shpjegon juve programin gjatë takimeve javore. Çdo ditë ju bëni një aktivitet me fëmijën tuaj, si për shëmbull të lexoni një libër ose të punoni me fletat e ushtrimeve.

Para se të filloni një aktivitet, është e rëndësishme të keni këto gjëra parasysh:

- Uluni të qetësuar me fëmijën tuaj për të bërë aktivitetin dhe lini mundësisht dhe fëmijë të tjer të lozin bashkë me fëmijën tuaj.
- Vini re nëqoftse kjo i bën qef fëmijës tuaj, nëqoftse jo, provoni të bëni një shaka, një lodër ose diçka të ngjashme për ta motivuar atë.
- Bëni gjithmonë aq shumë aktivitete sa mundeni, por ama vetëm në formë lodre dhe pa e bërë atë detyrë.

Këto ju duhen:

- Fletat e instruksioneve për prindërit,
- Fletat e ushtrimeve për fëmijët,
- Lapsa, goma, ngjitës, gërshër, lapsa me ngjyra, letra, e kështu me radhë.

Ky shëmbull për planin një jave ju tregon juve se sa kohë mundeni të mereni me fëmijën tuaj me programin Rucksack.

Dita	Aktiviteti	Koha	Materiali
E hënë	Figurë për të folur	15 min.	Fletat e ushtrimeve
E martë	Libër	20 min.	Libër
E mërkur	Fletë ushtrimi	15 min.	Fletat e ushtrimeve
E enjte	Lojë për të folur	20 min.	Fletat e ushtrimeve
E premte	Lojë për të folur	15 min.	Fletat e ushtrimeve

Aktivitetet



Figura për të folur

Figurat për të folur mundet të përdoren në mënyra të ndryshme. Me ato mundeni:

- të thoni çfarë shikoni në figurë,
- të flisni bashkë për figurën,
- të tregoni çfarë i lidh gjërat e ndryshme me njëra tjetrën (për shëmbull çadër dhe shi).
- të bëni pyetje për figurën (në fillim pyetje të thjeshta, si për shëmbull “Sheh ti një fëmijë?”, pastaj pyetje më të vështira si për shëmbull “Pse u rëzua fëmija?”),
- të thoni emrat e gjërave në figur, dhe të shpjegoni për çfarë ato duhen,
- të numëroni gjërat,
- të kërkoni gjëra të kundërta (për shëmbull e madhe – e vogël, e pastër – e pistë),
- të diskutoni si situacioni në figurë mundeshe të vazhdonte të zhvilloheshe,
- të krijoni lidhje midis figurës dhe eksperiencës të fëmijës tuaj (për shëmbull “je rezuar dhe ti ndonjë herë nga biçikleta jote?”).

Perdorni ndonjë herë dhe një reklam ose një gazetë dhe flisni për atë.

Ju urojmë që të keni shumë qef duke folur!



Të lexosh

Fëmijve ju pelqen kur ju lexon diçka. Fëmijët pyesin shpesh herë për të njëjtin libër (disa herë pesë herë njëra mbas tjetrës). Kjo është në regull kështu. Këtu ata mundet të mësojnë shumë gjëra, jo vetëm fjalë të reja por edhe të krijojnë eksperiencë dhe të përpunojnë situacione dhe ngjarje.

Ti lexosh tjetrit:

- Lexoni në atë gjuhë të cilën ju e dini më mirë.
- Ju mundet dhe ta ri-tregoni një histori me fjalët tuaja.
- Flisni qartë dhe me një ritëm të qetë.
- Lëreni fëmijën tuaj të reagojë mbasi i lexuat historin.
- Shikoni bashkë çdo figurë në çdo faqe dhe flisni për atë.
- Mos i lexoni shumë përnjëherësh.
- Nëqoftse fëmija juaj nuk e komenton historinë, ju mundeni të bëni pyetje:
 - për çfarë bëheshe fjalë në histori?
 - Çfarë ndodhi me ... ?
 - Kush është shoku i atij? e kështu me radhë.
- Pyeteni në fund nëqoftse fëmija juaj do që të thotë ose të pyesi diçka.
- Nëqoftse kini mënyrën tuaj të leximit që i pëlqen fëmijës tuaj, atëhere vazhdoni ta praktikoni këtë
- Lexojini, simbas mundësive tuaja, çdo ditë diçka.

Ju urojmë që të kini shumë qef duke lexuar!

Të Lozësh

Kërko të njëjtat

Kjo lojë është e përshtatshme për të ushtruar perceptimin, sepse fëmija juaj duhet të shikojë tamam dhe të mendohet.

- Filloni me 6 figura, 3 piktura të ndryshme, secilën githmone dy her, në atë farë mënyre për të krijuar çifte.
- Lëreni fëmijën tuaj ti kërkojë figurat e njëjta, dhe ti vëri ato bashkë (të krijojë çifte).
- Nëqoftse fëmija juaj e mësoi lojën me 6 karta, mundeni ta zmadhoni lojën me 12 ose me 24 karta.

“Memory” (Memorja)

Memory është një lojë e mir për të ushtruar mëndjen.

- Kthehini të tëra kartat me fytyrë nga posht.
- Një lojtar mundet të ktheji dy karta tashti; nëqoftse këto të dyja kanë të njëjtën figur, lojtari mundet ti mbajë ato dhe të ktheji dy karta të tjera, deri sa të gjejë dy karta që nuk janë njësoj. Nëqoftse kartat janë të ndryshme, atëherë ai duhet ti kthejë ato prapë mbrapsht dhe pastaj e ka radhën lojtari tjetër.
- Lojtari tjetër në radhë kthen prapë dy karta.
- Kush ka mbledhur më shumë karta në fund të lojës ka fituar.

“Kimspiel”

Dhe loja “Kimspiel” është një lojë për të cilën ka nevojë të shikosh me vëmendje, dhe të mbash mend gjëra.

Për këtë lojë duhen sende të ndryshme. Në këtë shëmbull përdoren sende nga guzhina: një lugë, një picetë tenxhereje, një karamele, një filxhan. Vini një peshqir duarve mbi këto sende, ashtu që aji ti mbulojë ato.

Lëreni fëmijën tuaj ti mbylli sytë, hiqni diçka që është poshtë peshqirit, dhe fshiheni atë send.

Fëmijës tuaj tashti i lejohej të shikojë prapë. Hiqeni peshqirin dhe lëreni fëmijën tuaj të thotë cili send mungon.

Kjo lojë mundet të lozet me sende të ndryshme:

- me lodra,
- me sende të përditshme e kështu me radhë

Këtë lojë shpeshë mundeni ta përsërisni disa herë me ndryshime ose plotësime të vogla.

“Papageienspiel” (loja e papagallit) – ushtrim për të folur

Në lojën e papagallit fëmija juaj mëson të dëgjojë me vëmendje dhe ti thotë fjalët në mënyrë të saktë. Kjo është një aftësi e rëndësishme që e ndimon fëmijën tuaj më vonë, kur ai mëson të lexojë. Kjo aftësi paraprake quhet vetëdije fonologjike, kjo do të thotë që fëmija juaj të fillojë të njohi tingullin specifik të gjuhës. Aji duhet të mësojë ti thotë fjalët tamam, kjo do të thotë përshëmbull që të dallojë zanoret, bashktingullore dhe rokjet ose pyetjet dhe thënjet. Vëmëndja për gjuhen mundet të fitohet shumë mirë me këngë fëmijve, vargje, rime, frasa të komplikuar, loja falve, e kështu me radhë. Vetëdija fonologjike e tregon veten e saj në aftësin e të ndarjes e një fjale në pjesë të vogla, për shëmbull të ndash një fjalë në rokje ose në aftësin të gjesh rime.

Ushtrimet për të folur duhet të ndodhin gjithmonë në mënyrë loje. Gjat këti programi kjo lojë lozet në mënyra të ndryshme:

- Të dëgjoshë fjalë, zanore dhe bashktingullore dhe ti thuash ato,
- të ndash fjal të reja të vështira në rokje,
- të krijosh rime për fjalë,
- të kërkojë gjëra të kundërta.



Tema reth vitit

Të shikosh televizor me fëmijët

Mediat që transmetohen ndërmjet ekranit (televizori, kompjutri, e kështu me radhë) janë të dëmshme për vëmëndjen dhe të mësuarën e leximit për fëmijët dhe risin tendencën për të përdorur dhunë si dhe dhunën vetë.

“Prandaj ka ardhur koha që të mendohemi çfarë mundemi që të bëjmë për ti trajtuar këto efekte të dëmshme me masa të suksesshme” (shikoh Manfred Spitzer, 2005. Faqia 281)

10 regullat e artë të përdorimit të televizorit

Ai ka hyrë në shumë dhoma fëmijve, televizori. Fëmijët e vegjel janë të magjepsur nga figurat shumngjyrshe. [...] Si munden prindërit ta drejtojnë përdorimin e televizorit dhe të flasin me fëmijët e tyre për atë? “SCHAU HIN!” (shiko atje) – me 10 regullat e artë të televizorit.

- 1. Të vendosësh regulla

Vendosni me fëmijët tuaj regulla të qarta, kur, sa gjat dhe çfarë ata janë të lejuar të shikojnë në televizor dhe kujdesuni që ata ti plotsojnë regullat. Prej kësaj arsye nuk duhet vënë televizori në dhomat e fëmijve, se ska pothuajse as një mundësi më për ta kontrolluar përdorimin.

- 2. Shikoni bashkë televizor

Televizori nuk bën punë si një bebisiter. Shikoni, sa her që mundeni, bashkë me fëmijët tuaj televizor. Sindomos fëmijë parashkollor dhe në shkollën fillore kanë nevojë për shoqërimin tonë. Emisione të njohura dhe video, për të cilat ju e dini që janë të përshtatshme, fëmijët mundet edhe ti shikojnë vetëm ndonjë herë.

- 3. Flisni për eksperiencë

Vini re signalet e fëmijës tuaj kur ai shikon televizor dhe pergjigjuni atyre. Dhe mos u irritoni nëqoftse fëmija juaj flet duke parë televizor, ose vjen vërdall në dhomë. Në këtë farë mënyre ai e përpunon eksperiencën e të parit të televizorit.

- 4. Televizori nuk është mjet presioni

Televizori nuk duhet të përdoret si mjet për ta shpërblyer dhe për ta dënuar fëmijën. Televizorit i jepet kështu një kuptim që nuk ka lidhje

direkte mv arsyen e vertët të dënimit (për shëmbull dhoma është remujë), dhe interesa për të par televizor ritet akoma më shumë prej moslejit.

- 5. Përdorimi kritik

Mundohuni ti ndimoni fëmijët që ta përdorin televizorin vetë dhe në mënyrë kritike. Ndimohini ata që ti dallojë emisionet dhe reklamat qartë nga njëra tjetra. Ju duhet të flisni me ata dhe për ekspozimin e dhunës.

- 6. Mos ndërtoni programin e ditës mbas televizorit

Mos e lini televizorin t'ju diktoj programin e ditës. Nëqoftse ju ose fëmijët tuaj duhan ta shikojnë një emision me domozdo, atëhere përdorni inçizuesin e vidiove ose të disqeve DVD. Nuk ka arsye për të lënë çdo gjë në mes për të parë emisionin.

- 7. Funksion shëmbullor

Rimendoheni dhe njëherë si shëmbull për fëmijët tuaj përdorimin tuaj të televizorit. I ndroni kanalet deri sa të dali një gjë interesante, ose i zghidhni emisionet me vëmendje të plotë? Më mirë do ishte ta ndiznit televizorin për një emision të caktuar dhe ta fiknit pastaj prapë.

- 8. Shkëmbim eksperiencave

Influenca juaj mbi fëmijën tuaj ndron sa më shumë që ai ritet: fëmijët orientohen më vonë më shumë tek shokët, shoqet dhe moshatarë të tjer me të cilët ata kalojnë kohën. Prandaj shkëmbihuni me prindër të tjer për tema si për shëmbull përdorimi i televizorit, reklama në televizor ose ekspozime dhune.

- 9. Me ndërgjegje të qet

Fëmijve ju duhet televizori njësoj si të riturve: për tu informuar dhe të mësuar, për tu qetsuar, për tu argëtuar, për të krijuar një botë të vetë fantasie. Rini me ndërgjegje të qetë edhe nëqoftse fëmija juaj nuk shikon vetëm emisione me vlerë pedagogjike. Ose që shikon televizor në vënd që të lozi lojra me “kuptim” me fëmijë të tjer.

- 10. Fikeni nga një herë

Kini kujdes që fëmijës tuaj ti ngelet kohë për të lozur, për sport si dhe për shokët dhe shoqet. Televizori nuk duhet që të jet aktiviteti i vetëm i

ndalohet një fëmijë në mënyrë kategorike. Ai duhet të mësohet të gjeji drejtimin e tij në një botë që dretohet fort prej mediave. Ju duhet të gjeni mesin e artë: mos e beni televizorin shejtan, por vini reh se cfarë fëmija juaj sheh.

burime: Spitzer, Manfred: Vorsicht Bildschirm, Ernst-Klett-Verlag, Stuttgart 2005
www.schau-hin.info

Të ndjesh natyrën



Në natyrë fëmijët gjejnë shumë mundësira për të krijuar eksperiencë dhe të zbuluar gjëra të reja, të cilat me shumëllajshmërinë e tyre ngjallin ndjenjat dhe perceptimin, si dhe shpirtin e tij shkenctar.

Veç kësaj, kështu mundet mundet të eksperiencohet dhe të eksplorohet ambienti natyral (baçja, parku, pylli, lulishtja, lumi). Kjo është një eksperiencë shumë e vlefshme për fëmijët.

Nëqoftse fëmijët e njohin natyrën dhe dinë ta vlersojnë atë që nga mosha të vogla, atëherë ata krijojnë një lidhje pozitive me ambjentin e tyre. Është e rëndësishme t'ju krijojnë fëmijëve vendë në të cilat ata mundin ta zbulojnë natyrën duke lozur dhe në mënyrë kreative.

Këto janë disa ide:

- Shkoni më shpeshë me fëmijën tuaj në natyrë, për shembull në parkun, në një pyll që është afër, një liqen ose lumë.
- Vini re bashkë me fëmijën tuaj si natyra ndron gjatë stinëve të ndryshme të vitit (ndryshime tek pemët, ferrët, lulishtet, lulet, e kështu me radhë)
- Mendohuni bashkë me fëmijën tuaj se sa forma të ndryshme të pemëve, ferrave, luleve, e kështu me radhë fëmija juaj një.

- Mundohuni të ndjëni erërat e ndryshme të natyrës, përshëmbull erën e luleve, bimëve, barëve, të tokës.
- Djëgjoni bashkë me fëmijën tuaj zhurmat e ndryshme të natyrës (për shëmbull erën kur fryn, shiun, vetëtimën, fletat e pëmve kur fryn era, lumin si riedh, zërat e kafshëve).
- Ndieni (me duart tuaj) bashkë me fëmijën tuaj materiale të ndryshme të natyrësh (për shëmbull koren e pëmës, tokën, myshk, rërën, gurë, barin, ujin, baltën).
- Mblidhni bashkë me fëmijën tuaj materialet të ndryshme të natyrës (për shëmbull (gurë, shkopa, fleta peme, koren e pemës, gështënja, rërën, lulet). Me këto gjëra ju mundeni të lozni ose ndërtoni diçka.
- Informohuni bashkë me fëmijën tuaj cilat kafshë jetojnë në natyrën e hapur dhe flisni për ato (insektet, kërmillët, zogjët, ketërët, lepujt, e kështu me radhë).
- Shikoni me vëmëndje bashkë me fëmijën tuaj, gjatë një kohe të gjatë se si rritet dhe lulëson një lule nga fara. Diskutoni me fëmijën tuaj se si aji duhet të kujdeset për lulen dhe çfarë vlerë kanë drita dhe uji për lulen.
- Flisni me fëmijën tuaj për rëndësin e natyrës dhe se si neve mundemi ta mbrojmë atë. Shpegojini fëmijës tuaj që mos shkulli lule, mos thyejë degë dhe mos torturojë ose vراسi kafshë.
- Shpegojini fëmijës tuaj që mos hedhi plera në natyrë (pyll, lulishte, lumë, e kështu me radhë).
- Flisni me fëmijën tuaj dhe për reziqet në natyrë, për shëmbull lule dhe kërpudha helmuese, kafshë të egra).

Të festosh festa



Të festosh bashkë nuk është vetëm për të bërë qef dhe tu kënaqur, por edhe zhvillon ndjenë e shoqërisë dhe tolerancën e çdo anshme.

Pregatitja dhe koha përpara festës janë të lidhura me një parapritje të madhe, sindromë për fëmijët.

Festat janë kulmet gjatë vitit. Ato janë arsye për tu takuar me familjen, shokët dhe komshinjtë, të shkëmbyer me njëri tjetrin dhe për të mbajtur rituale të përbashkta. Ato krijojnë mundësi për ti bërë qefin dikujt tjetri. Për shumë festa një pjesë e rëndësishme e festës është ti falësh të tjerëve dhe të të falin të tjerët diçka.

Për të integruar mundësisht sa më shumë festa të ndryshme në punën KiTa kopshti ka nevojë të bashkëpunojë me prindërit. Për këtë është e rëndësishme që t'ju vijet veshi ritualeve dhe traditave dhe ana fetare e familjes të anashkalohet.

Këto janë disa ide:

- Ju mundeni të flisni me fëmijën tuaj për festat që janë të rëndësishme për ju dhe si i keni kaluar ju ato kur ishit të vegjël. Përfshihen fëmijën tuaj në planifikim dhe drejtimin e festave tuaja.

- Shkëmbeuni me prindërit e tjerë dhe pedagogët e specialisuar nga KiTa se si mundën të festohen festa të ndryshme bashkë në KiTa. Përfshihini edhe këtu fëmijët në mendimet tuaja.
Është një pasurim për ju dhe fëmijën tuaj nëqoftse juve njihni festa, rituale, zakone dhe tradita prej kulturave të tjera.
- Aktivitete konkrete mundën të planifikohen dhe dretohen bashkë për KiTa:
 - të gatosh dhe të pjekësh sëbashku
 - të ndërtosh peshqeshe të vogla dhe të zbukurosh dhomat,
 - kërcime, këngë dhe pjesë teatri,
 - historira, pralla, vjersha dhe rime.



Temat kryesore

Trupi



Trupi është diçka që i intereson shumë fëmijës. Çdo njëri ka një trup dhe çdo njëri është kurioz, për të mësuar, si ai punon dhe çfarë mundësi ai ofron.

Tema përbëhet prej disa pjesëve:

- Fytyra
- Lëvizja
- Krahë dhe këmb
- Organet e brëndshme
- Organet e shqisave
- Foshnje dhe njerëz të vjetër
- Ritja

Ju mund të përdorni shumë situazione të ndryshme, për të folur me fëmijën për trupin, për shëmbull fëmijët normalisht bëjnë shumë pyetje kur janë duke u larë, duke u veshur dhe xhveshur para pasqyrës ose duke lozur me kuklla.

Shumë qef me trupin!

JAVA 1: TRUPI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqet 2 dhe 3 të fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë,
- Një pasqyrë.

Fëmija juaj mëson:

pjesët e ndryshme të fytyrës.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj të vizatojë dhe njëher fytyrën e hënës që është në faqen 2 dhe i thoni atij vjershën gjatë kohës që ai është duke vizatuar.

GEDICHT

Der Mond ist rund,
der Mond ist rund,
er hat zwei Augen Nase und Mund.

VJERSH

Hëna është e rumbulakët,
hëna është e rumbulakët,
Ka dy sy, hundë dhe gojë

- Dilni përpara pasqyrës bashkë me fëmijën tuaj dhe thoni emrin e pjesve të ndryshme të fytyrës.
- Lëreni fëmijën të vizatojë një fytyrë tek faqa 3

Detyra shtesë:

- Lëreni fëmijën të lahet vetë. Shikojeni atë gjatë kësaj kohe tamam çfarë ai bën: sa mirë lahet ai dot vetë? Për cilat pjesë të trupit interesohet ai më shumë?
- Flisni gjatë kohës që po e lani ose po e vishni fëmijën për pjesët e ndryshme të trupit për shëmbull:
 - “Hapi sytë e tua!”
 - “Mbylli sytë e tua!”
 - “Hap një sy dhe mbyll tjetrin!”
 - “Hapi që të dy sytë, mbylli që të dy sytë!”

Dita 2

Detyra:

- Shikoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet të librit)

Detyrë shtesë:

- Mundohuni të rimoni me fëmijën tuaj këto fjalë:
 - Hënë
 - Gojë
 - Sy
 - Hund

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 4 e fletëve të ushtrimeve,
- një lëmshe prej leshi,
- një gërsërë.

Fëmija juaj mëson:

fjalët *gjatë* dhe *shkurt*.

Detyrat:

- Prisni me fëmijën tuaj penj të gjatë dhe të shkurtër nga lëmshe.
- Lëreni fëmijën të vizatojë tek faqa 4 në një fytyrë me flokë të gjata dhe një tjetër me flokë të shkurtër.

Detyrë shtesë:

- Flisni për shëmbul kush i ka flokët e gjata dhe kush të shkurta në familje, ose shikoni cilët nga komshinjtë kanë perde të gjata dhe cilët të shkurtëra dhe kështu në vazhdim.

Dita 4

Ju duhet:

- Një kukull ose një arush lodre.

Fëmija juaj mëson:

Emrin e pjesëve të trupit dhe ti tregojë ato, fjalët *e madhe* dhe *e vogël*.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën ti tregojë pjesët e trupit dhe tju thotë atyre emrin tek një arush lodre.
- Lëreni fëmijën të krahasojë kush është më i madhi dhe kush më i vogli në familje dhe kështu në vazhdim.

Detyrë shtesë:

Ju duhet:

- restin e një role tapet muri,
- një gërshërë,
- një lapsë,
- rota ngjitëse për paketim e mdhe ose e vogël.

Fëmija juaj mëson:

ta shikojë veten e tij në një madhësi tjetër.

- Hapeni tapetin e murit në tokë, shtrihuni mbi të dhe lëreni fëmijën të vizatojë trupin tuaj, pastaj ju vizatoni trupin e fëmijës tuaj. Tashti çdo njëri pret figurën e trupit të tij. Montoini këto tek muri ose tek një derë me rolen ngjitëse të madhe ose me rolen e vogël. Lëreni fëmijën ti tregojë pjesët e trupit tek figura dhe t'ju thotë emrat atyre.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 5 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë.

Fëmija juaj mëson:

pjesë të ndryshme të trupit,
të shoqerojë një këngë me lëvizjet e duarve.

Detyrat:

- Këndoni këngën.
- Flisni me fëmijën për figurën tek faqa 5, për shëmbull:
 - “Çfarë po vizaton djali?”
 - “Sytë e kukllës tek figura janë të hapura apo të mbyllura?”
 - “Çfarë i mungon kukllës?” (gishtat e këmbës, qafa, ...)

LIED

Kopf, Schulter, Knie und Zehen, Knie und Zehen,
Kopf, Schulter, Knie und Zehen, Knie und Zehen,
Augen, Ohren, Nasenspitze,
Kopf, Schulter, Knie und Zehen, Knie und Zehen.

KËNG

Koka, supi, gjuri dhe gishtat e këmbës, gjuri dhe gishtat e këmbës,
Koka, supi, gjuri dhe gishtat e këmbës, gjuri dhe gishtat e këmbës,
Sytë, veshët, maja e hundës,
Koka, supi, gjuri dhe gishtat e këmbës, gjuri dhe gishtat e këmbës,

Detyra sthesë:

- Flisni me njëri tjetrin çfarë mund të bëni me këto pjesë të trupit:
 - sytë
 - këmbët
 - duart
 - hundën
- Çfarë do ndodhte nëqoftse nuk do i kishim ato?

JAVA 2: TRUPI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 6 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë,

Fëmija juaj mëson:

të mësojë një vjershë të shkurtër përmëndësh,
të bashkojë pikat në një vizatim.

Detyrat:

- Përsëriteni vjershën për hënën.
- Lëreni fëmijën ti bashkojë pikët në faqen 6.

GEDICHT

Der Mond ist rund,
der Mond ist rund,
er hat zwei Augen Nase und Mund.

VJERSH

Hëna është e rumbulakët,
hëna është e rumbulakët,
Ka dy sy, hundë dhe gojë

Detyra shtesë:

- Shikoheni bashkë hënën dhe flisni me njëri tjetrin për natën dhe yjet.
- Lëreni fëmijën që të flasi për figurën tek faqia 6, për shëmbull:
 - “Ka sy të mëdhejn fëmija?”
 - “Ka shumë flokë fëmija?”

Dita 2

Detyra:

- Shikoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit)

Detyrë shtesë:

- Këndoni bashkë një këngë për lojra për shëmbull “Meine Hände sind verschwunden” (“Duart e mia u zhdukën”).

SING-SPIEL „Meine Hände sind verschwunden“

Meine Hände sind verschwunden,
ich habe keine Hände mehr,
seht da sind meine Hände wieder
trallalalalalala

(Hände hinter den
Rücken verstecken)

Meine Nase ist verschwunden,
ich habe keine Nase mehr,
seht da ist meine Nase wieder
trallalala...

(Nase mit einer Hand
verstecken)

Meine Augen, Ohren sind verschwunden...

Mein Kind das ist verschwunden,
ich habe kein Kind mehr,
seht da ist mein Kind ja wieder
trallalala...

(Das Kind versteckt
sich in der Wohnung)

KËNGË PËR LOJRA “Duart e mia u zhdukën”

Duart e mia u zhdukën,
unë nuk kam më duar,
shikoni këtu janë duart e mia prapë
tralalalalalala

(fshihi duart
mbrapa kurizit)

Hunda ime u zhduk,
unë nuk kam më hundë,
shikoni këtu është hunda ime prapë
tralalala...

(fshihi hundën
me një dorë)

Sytë, veshët e mia humbën ...

Fëmija ime u zhduk,
unë nuk kam më fëmijë,
shikoni këtu është fëmija ime prapë
tralalala...

(fëmija fshihet
diku në shtëpi)

Dita 3

Ju duhet:

- Faqa 7 e fletëve të ushtrimeve,
- lapsa me ngjyra.

Fëmija juaj mëson:

Emrat e ndryshme të gishtave,
pjesët e ndryshme të këmbës.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën t'ju thotë emrin e gishtave të dorës të tij: gishti i madh, gishti tregues, gishti i mezit, gishti i unazës, gishti i vogël dhe pjeset e ndryshme të këmbës: gishtat, kavilen, thembrën e shputa. Mendohuni bashkë nëqoftëse ka ndonjë vjershë ose këngë për gishtat.
- Në faqen 7 kaloni një vizë rreth e rrotull këmbës dhe dorës të fëmijës tuaj dhe pastaj lëreni atë që të vizatojë detajet. Bëni të njëjtën me dorën dhe këmbën tuaj.

Detyrë shtesë:

- Luani me fëmijën tuaj lojën e gishtave.

FINGERSPIEL

Das ist der Daumen,
der schüttelt die Pflamen,
der hebt sie auf,
der bringt sie nach Haus,,
und der kleine,
der isst sie alle auf.

(Daumen anfassen und zeigen)
(Zeigefinger anfassen und zeigen)
(Mittelfinger anfassen und zeigen)
(Ringfinger anfassen und zeigen)
(Kleinen Finger anfassen und zeigen)
Und dann sich oder dem Kind den
Bauch streicheln, als Symbol für das
Essen der Pflaumen)



LOJA E GISHTAVE

Ky është gishti i madh,	(kapeni gishtin e madh dhe tregoheni)
ky shkund kumbllat,	(kapeni gishtin tregues dhe tregoheni)
ky i mbledh ato,	(kapeni gishtin e mesit dhe tregoheni)
ky i sjell ato në shtëpi,	(kapeni gishtin e unazës dhe tregoheni)
dhe i vogli,	(kapeni gishtin e vogël dhe tregoheni)
i ha ato të tëra.	dhe pastaj fërkoni barkun tuaj ose të fëmijës si treguesin e të ngrënës së kumbllave)

Dita 4

Ju duhet:

- Një shkop magjik (një garuzhde ose ndonjë gjë e ngjashme).

Fëmija juaj mëson:

Të thotë emrin pjesve të ndryshme të trupit.

Detyrat:

- Uluni ballë-përballë me fëmijën tuaj. Filloni të bëni “magji”. Mereni shkopin magjik dhe thoni një “fjalë magjike”, për shëmbul: “Hokus, pokus, fidibus, tre herë maçok i zi! U zhduk dora/goja/gishti i mezit/gjuri/kavilja/e kështu me radhë.” (Mundet dhe të shpikni vetë një fjalë magjike) Gjatë kësaj prekeni atë me shkopin magjik tek pjesa e trupit që do zhduket (për shëmbull dorën). Fëmija juaj e fsheh dorën mbrapa kurizit ose mbulon hundën me të dyja duart e kështu me radhë.
Magjira të tjera mund të jenë: “Tunde prapanicën tënde/gishtat e këmbës tënde/veshët e tua”, “Hec në majë të gishtave/vetëm me një këmbë/me këmbë e duar”, “Ulu mbi duart e tua”, e kështu me radhë.
Pas një farë kohe ndëroni rolet, tashti fëmija është “magjistari”.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 8 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë,
- Një copë sapun,
- Një peshqir.

Fëmija juaj mëson:

të digjojë dhe të bëjë një detyrë,
fjalët *ngrohtë* dhe *ftohtë*.

Detyrat:

- Lani duart tuaja dhe mësoni dhe fëmijën ti lajë duart e tij, njëherë me ujë të ngrohtë dhe njëherë me ujë të ftohtë. Mësoni fëmijën të tregojë çfarë ndryshimi ndjevi.
- Flisni me fëmijën për figurën tek faqa 8, për shëmbull:
 - “Çfarë shikon tek figura?”
 - “Çfarë po bën fëmija?”

Detyrë shtesë:

- Mësoni fëmijën të kërkojë artikuj të ndryshëm në supermarket, që përdoren për të pastruar veten, për shëmbull: sapun, letër higjienike, pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, e kështu me radhë.

JAVA 3: TRUPI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 9 e fletëve të ushtrimeve,
- Një gërshërë,
- Ngjitës,
- Roba që janë për të larë dhe roba të pastra,
- Gazeta dhe reklama.

Fëmija juaj mëson:

Fjalët e pastër dhe pisë,
çfarë vjen erë të mirë dhe çfarë erë të keqe.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj t'ju mari erë robave të pista dhe robave të pastra.
- Në faqen 9 ngjisni bashkë një kukull prej pjesve të ndryshme. Lëreni fëmijën për shëmbull të presi një këmbë për kukullën prej gazetës dhe këmbën tjetër prej letrës së një reklame.

Detyra shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj ti fusi robot në lavatriçe dhe ta zbrazti atë mbasi të ketë mbaruar larja.

Dita 2

Detyra:

- Shikoni bashkë një libër me figura dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit)

Detyrë shtesë:

- I thoni fëmijës tuaj të bëjë këto gjëra për të krijuar ide të tjera të lëvizjes:
 - ne po hecim si një plak,
 - ne po bëjmë sikur jemi të trashë,
 - ne po shtrihemi si një bebe,
 - ne po këpusim një mollë nga pema e lartë,
 - ne po bëhemi të vegjël dhe pastaj po ritemi prapë avash.

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 10 e fletëve të ushtrimeve,
- një gërshërë,
- letër higjenike,
- një sapun
- një peshqir

Fëmija juaj mëson:

të flasi për gjërat të përditëshme.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj të flasi për peshqirin, për shëmbull:
 - “Është peshqiri i fort ose i but?”
 - “Për çfarë e përdor ti?” (Në këtë lloj forme mund të flisni dhe për gërshërën dhe letrën higjenike.)
- Lëreni fëmijën tuaj ti lajë duart e tij vetë me sapun dhe shikojeni: sa i pavarur është ai gjatë kësaj?
- Lëreni fëmijën ti heqi vizë çdo gjëje që nuk e ka vëndin në rjesht.

Detyra shtesë:

- Lëreni fëmijën të thotë fjalë që kanë të bëjnë me banjën (për shëmbull mbajtësen e sapunit, furça e dhëmbve, peshqiri, e kështu me radhë)
- Këndoni këngë nga vëndi juaj.

Dita 4

Ju duhet:

- Një pasqyrë dore,
- një batanije,
- musikë të qetë.

Fëmija juaj mëson:

të ndjejë trupin e tij.

Detyrat:

- Krijoni një atmosferë të qetë duke e erësuar dhomën pak dhe (ndoshta) duke vënë muzikë të qetë me zë të ulët ose muzikë qetësuese. Shtroni një batanije në tokë. Shtrijuni bashkë me fëmijën tuaj tek ajo.

Bëjini atij këto pyetje dhe jepini mbas çdo pyetje kohë që ti provojë ato:

- “Mund të dëgjosh si reh zëmra jote?” (Në qoftëse fëmija juaj ka probleme që ta bëjë këtë lëreni ta vëri veshin e tij në gjoksin tuaj, kështu ai dëgjon zëmrën tuaj.)
- “Mund ta dëgjosh stomakun tim/zorët e mija si punojnë?” (Lëreni fëmijën të digjojë tek barku juaj zhurmat e stomakut dhe të zorëve.)
- “Mund ta dëgjosh frymarien tënde kur mer frymë avash dhe fort?” (Mëreni pasqyrën e dorës dhe i thoni fëmijës që ta mbajë atë përpara hundës dhe gojës gjat kohës që mer ajër. Pasqyra do bëhet me avull, kështu ai mund ta shikojë frymën e tij.

Detyra shtesë:

- Flisni për ndrimin e dhëmbëve dhe pse duhet të pastrohen dhëmbët.
- Flisni për pjesët e trupit që nuk duken (për shëmbull kockat, gjakun, muskullat, enët e gjakut).

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 11 dhe 12 e fletëve të ushtrimeve,
- lapsa me ngjyrë.

Fëmija juaj mëson:

të përsërisi fjalët në regull,
fjalët *ngrohtë* dhe *ftohtë*.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj të vizatojë çdo gjë të ngrohtë me të kuqe dhe çdo gjë të ftohtë me blu në faqa 11.
- Lozni Silbenklatschen (të ndash në rokje) me këto fjalë:

- Sei-fe, Sei-fen-scha-le,
- Fuß, Fuß-soh-le,
- Hand, Hand-tuch,
- Ohr, Ohr-mu-schel,
- Na-se, Na-sen-loch,
- Mund, Mund-win-kel
- usw.

sapuni, mbajtsja e sapunit,
këmba, shputa,
dora, peshqiri,
veshi, llapa e veshit,
hunda, vrima e hundës,
goja, anët e buzve,
e kështu me radhtë.

Detyra shitesë:

- Flisni për rethin, trekëndshin dhe katërkëndshin.
- Lëreni fëmijën ti vizatojë të tëra katërkëndshat në faqen 12 me të verdhë.

Robat



Mbas trupit, vjen tema “robat”. Trupi është pothuajse gjithmonë i mbuluar me roba. Trupit tonë i duhen robat për tu mbrojtur nga i ftohti.

Tema përbëhet prej disa pjesëve:

- Robat e poshtme dhe të sipërme,
- roba për festa,
- roba për dimrin dhe për verën,
- roba për ritet fetare,
- roba pune.

Për të zgjidhur detyrat e ndryshme që ka ky program nevojitet një kuti me roba maskimi.

Prandaj do ishte mirë të pregatisni një kuti me roba për maskim. Gjërat e përshtatshme për tu futur atje janë:

- Pulovra të madhësive të ndryshme,
- një fund,
- një fustan,
- një palë të mbathura,
- një këmishe,
- një këmishë për tu veshur sipër,
- një palë pantallona për burra,
- një kravatë,
- një palë roba gjumi,
- një këmishë nate,
- e kështu me radhë.

Juve mundeni dhe të fusni stoli të ndryshme:

- një varse,
- një rip,
- xhevahire,
- një çantë e kështu me radhë.

Do ishte mire ta linit kutinë gjatë gjithë kohës në një vend, ku fëmija mundet dhe të lozi me të. Të maskohet do të thotë për një fëmijë të lozi një rol: Ai bën sikur është një princ ose një zjarfikës.

Fëmijët mund të mësojnë shumë gjatë lojës me maskimet. Shumë eksperiencia formohen në këtë mënyrë. Kjo vlen si për djemtë dhe vajzat.

Ju urojmë shumë qef me veshjet!

JAVA 1: ROBAT

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 14 e fletëve të ushtrimeve,
- Roba në madhësi të ndryshme.

Fëmija juaj mëson:

emrat e robave të ndryshme,
madhësitë e ndryshme.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj të provojë roba në madhësi të ndryshme përpara pasqyrës.
- Lëreni fëmijën tuaj ti vëri robot njëra mbi tjetrën dhe të shikojë ndryshimin e madhësive.
- Flisni me fëmijën për figurën tek faqia 14

Detyra shtesë:

- Lëreni fëmijën t'ju thotë emrin robave që shikoni kur të jeni duke bërë pazarë në një dyqan robash.
- Lëreni fëmijën të shikojë pavione të veçanta, për shëmbul sportive ose për kapele/kapuça.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet të librit)

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të vishet sikur ai është duke shkuar në një festë. Përdorni për këtë punë kutinë me roba maskimi.

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 15 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë,
- Roba vere dhe dimri.

Fëmija juaj mëson:

Ndryshimin e robave të verës nga të dimrit,
ngyrat e *kuqe* dhe *blu*,
fjalët *ngrohtë* dhe *ftohtë*.

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për ndryshimet mes robave të verës me robat e dimrit, për shëmbull:
 - “Janë robat e verës të trasha?”
 - “Kur vishen roba të holla?”,
 - e kështu me radhë.
- Lëreni fëmijën të vizatojë robat tek faqia 15: ato që janë për verë me të kuqe dhe ato që janë për dimër me blu.

Detyrë shtesë:

- Shpjegoni radhën e hapat e ndryshme kur vishesh dhe xhvishesh. Kjo e ndimon fëmijën tuaj të xhvishet dhe të vishet vetë.

Dita 4

Ju duhet:

- Kutija me robat e maskimit.

Fëmija juaj mëson:

të vishet.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën të vishet sikur përjashta është shumë ftohtë ose shumë ngrohtë.
- Shikoheni fëmijën duke u veshur dhe xhveshur: Sa është ai në gjëndje ti bëjë këto vetë? A mundet fëmija ti zgjedhi vetë robat që duhen veshur?

Detyrë shtesë:

- Kërkoni bashkë me fëmijën tuaj të rimoni emrat e robave të ndryshme, për shëmbull “kapele-dele”. Ju mundet të përdorni edhe fjalë të shpikura, për shëmbull: “pantallona-mona”.
- Lozni me fëmijën tuaj lojën e rokjeve.

LOJA E ROKJEVE

Shkruani sa më shumë që të jetë e mundur fjalë të temës aktuale në karta të vogla.

Lëreni fëmijën të terheqi një kartë dhe lexoini atij fjalën që ka karta. Përsëriteni bashkë me fëmijën fjalën dhe përplasni duart për çdo rokje të fjalës.

Shtesë (për fëmijë më të mëdhenj):

Filloni me lodrën njësoj si më sipër dhe lëreni fëmijën ti duartrokasi rokjet vetë. Nëqoftëse ai i gjen rokjet në regull, mundet të bëjë aq hapa sa rokje kishte fjala. Nëqoftëse ai u ngatrua, atëhere duartrokitni rokjet bashkë. Pastaj e ka radhën tjetri.

Sa shpejt e arin fëmija murin përballë?

Kush e arin më përpara atë?

Kjo lojë mund të luhet dhe me më shumë fëmijë.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 16 e fletëve të ushtrimeve,
- Një gërsërë,
- Roba për tu veshur.

Fëmija juaj mëson:

mënyrën më të shpejtë për tu veshur,
të dijë ta shpjegojë këtë mënyrë.

Detyrat:

- Vendosini robot e fëmijës tuaj në mënyrë të çregullt dhe i thoni fëmijës ti rendisi ato si mbas radhës që ai do i veshi ato.

- Flisni me fëmijën çfarë do ndodhte nëqoftse ai do vishte këpucët përpara se të kishte veshur çorapet.
- Lëreni fëmijën ti presi figurat tek faqia 16, ti rendisi dhe t'ju veri atyre numra. Për ta bërë këtë lëreni fëmijën të tregojë çfarë po ndodh në këto figura.

Detyra sthesë:

- Regulloni bashkë me fëmijën tuaj dollapin e robave. Përdorni fjalët e *madhe*, e *vogël*, *sipër* dhe *poshtë*.
- Pregatitni me fëmijën tuaj robot për të nesërmen.

JAVA 2: ROBAT

Dita 1

Ju duhet:

- Faqet 17 dhe 18 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë,
- Një kapele,
- Një pulovër,
- Një palë pantallona.

Fëmija juaj mëson:

të flasi për një figurë,
fjalët *sipër*, *për* dhe *brënda*.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën të veshi robat:
 - pulovrin ta kalojë mbi kokë,
 - kapelen sipër mbi kokë,
 - këmbën brënda në këmbën e pantallonit,
 - krahun brënda në mëngët e pullovrit
- Lëreni fëmijën të flasi për figurën në faqen 17.
- Lëreni fëmijën ta plotësojë figurën në faqen 18.

Detyrë shtesë:

- Luani lojën “Ich packe meinen Koffer” (“Unë pregatis valixhen time”).

SPIEL: "Ich packe meinen Koffer"

Spieler 1: sagt: "Ich packe meinen Koffer und nehme eine Hose mit."

Spieler 2: sagt: "Ich packe meinen Koffer und nehme eine Hose und einen Pullover mit"

Spieler 1: sagt "Ich packe meinen Koffer und nehme eine Hose, einen Pullover und mein Radio mit."

Spieler 2: ... usw.

Das Spiel kann auch mit personen gespielt werden.

LOJA: "Unë pregatis valixhen time"

Lojtari 1: "Unë pregatis valixhen time dhe mar një palë pantallona me vete."

Lojtari 2: "Unë pregatis valixhen time dhe mar një palë pantallona dhe një pulovër me vete."

Lojtari 1: "Unë pregatis valixhen time dhe mar një palë pantallona, një pulovër dhe radion time me vete."

Lojtari 2: ... e kështu me radhë

Kjo lojë mundet të luhet dhe me persona.

Dita 2

Detyra:

- Një valixhe ose një çantë.

Fëmija juaj mëson:

të mendohet, çfarë i duhet për të kaluar natën në një shtëpi tjetër,
të bëjë një valixhe gati.

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet të librit)

Detyrë shtesë:

- Pregatisni me fëmijën tuaj një valixhe ose një çantë sikur fëmija juaj do flinte në një shtëpi tjetër.

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 19 e fletëve të ushtrimeve,
- Këpuce me lidhëse të ndryshme.

Fëmija juaj mëson:

ti shikojë dhe ti ndjejë gjërat tamam,
të mësojë ti lidhi lidhëset e ndryshme të këpucëve saktë.

Detyrat:

- Thoni emrin e pjesëve të ndryshme të këpucës, për shëmbull maja, thembra, tabani.
- Diskutoni çfarë ndodh nëqoftëse lidhëset e këpucës janë të hapura.
- Lëreni fëmijën ta ngjyrosi figurën në faqen 19: të tëra robat e fëmijës 1 me jeshile; të fëmijës 2 me të kuqe; të fëmijës 3 me të verdhë; të fëmijës 4 me blu.

Detyrë shtesë:

- Mësojini fëmijës tuaj si ti lidhi këpucët.

Dita 4

Ju duhet:

- Kutija me robat e maskimit.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën të mendohet kush ka veshur çfarë robash sot në familje.
- Lëreni fëmijën tuaj të vishet për shëmbull si një sportist, një balerinë, e kështu me radhë.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqet 20 dhe 21 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë,
- Një gërshtë,
- Arusha lodre dhe një revistë reklame.

Fëmija juaj mëson:

të zgjedhi roba edhe ti presi ato simbas masës.

Detyra:

- Lëreni fëmijën tuaj të presi roba prej copa stofi të vjetër ose prej reklamës për fëmijët në faqen 20.

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën ta ngjyrosi figurën në faqen 21: rathët me të verdhë, katërkëndëshat të kuq, dhe trekëndëshat jeshil.

JAVA 3: ROBAT

Dita 1

Ju duhet:

- Faqet 22 dhe 23 e fletëve të ushtrimeve,
- Një gërshtë.

Fëmija juaj mëson:

të kombinojë,
radhën e gjërave që bën kur zgjohesh në mëngjes (ngrihesh, lahesh e kështu me radhë).

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për figurën në faqen 22 dhe mendoni bashkë çfarë mund të ndodhte pastaj.
- Lëreni fëmijën ti presi figurat në faqen 23 për gjatë vizave të ndërprera.
- Lozni bashkë lojën domino me kartat e sapo prera.

LOJA DOMINO

Shpërdajini gurët e dominove tek lojtarët.

Njëri vë një gur në tavolinë. Tjetri vë gurin e dytë në atë mënyrë që figura të shkojë me njërin nga figurat e gurit të parë, e kështu me radhë...

Nëqoftëse njëri nuk ka një gur që shkon, atëherë ai nuk mund të lozi kësaj radhe.

Kush i mbaron gurët i pari, fiton lojën.

Detyra shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të kërkojë tek shporta me robat e palara dy roba që shkojnë me njëra tjetrën, për shëmbull dy çorape (një palë) ose një këmishë dhe një palë pantallona.

Dita 2

Ju duhet:

- Kutija me robat e maskimit.

Detyra:

- Shikoni bashkë një libër me figura dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit)

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën të veshi një kombinacion të pazakontë robash, sikur ai do shkonte në karnavale.

Dita 3

Ju duhet:

- një peshqir i vogël.

Fëmija juaj mëson:

të shikojë tamam,
të mbaj mënd diçka,
të tregojë një përallë.

Detyrat:

- Lozni lojën “Kimspiel” me këto sende: një këpucë, një çorape, një krëhër, një kapuç, dhe një këmishë.
- Në fillim lëreni fëmijën tuaj t’ju thotë emrin këtyre sendeve.
- Përsëriteni lojën me sende të ndryshme.

Dita 4

Ju duhet:

- Gazeta, revista, the reklama të vjetra
- Një fletë letre e madhe,
- Ngjitës,
- Lapsa me ngjyrë.

Fëmija juaj mëson:

të njohi pjesë të ndryshme veshje,
ushtron lëvizjet e imta të tij.

Detyra:

- Lëreni fëmijën të presi copa veshjeje prej gazetave, revistave dhe reklamave, për shëmbull fustane, pantallona, këpucë, e kështu me radhe. Tashti fëmija juaj krijon njerëz prej këtyre robave, domethënë i vesh ata. Kokat dhe duart vizatohen në fund për ta plotësuar figurën. Kështu krijohet ne grup me njerëz të veshur në mënyra të ndryshme. Figura e Grupit mund të varet pastaj në dhomën e fëmijve për ta zbukuruar atë.

Detyra shtesë:

- Luani me fëmijën lojën “të ndërtojme rolet”. Fëmija zgjedh cili do jetë ai nga familija dhe kërkon pastaj roba që shkojnë me këtë rol.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 24 e fletëve të ushtrimeve,
- Një gërshtë.

Fëmija juaj mëson:

të kuptojë renditjen e një serie të kartave.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj ti presi figurat në faqen 24.
- Lëreni fëmijën tuaj ti rendisi figurat në regull.

Detyrë shtesë:

- Lexoni vjershën

GEDICHT

Herr Ruh, richten Sie mir den Schuh?
Ja, Frau Kuhn, das will ich gleich tun.
Herr Ruh, machen sie ihn fein?
Ja, Frau Kuhn, so muss es doch sein.

Herr Ruh, ist mein Schuh schon da?
Hier bitte, bezahlen Sie in bar.
Herr Ruh, ich habe doch kein Geld!
Dann wir der Schuh hierhin gestellt,
denn auf Kunden ohne Geld
bin ich heut' nicht eingestellt.

Guten Tag, Herr Ruh.
Guten Tag, Frau Ohne-Schuh.

VJERSHË

Zoti Ruh, do më regulloni këpucën?
Po, zonja Kuhn, do e bëj atë në moment.
Zoti Ruh, do e zbukuroni atë?
Po, zonja Kuhn, ashtu duhet të jetë.

Zoti Ruh, erdhi këpuca ime?
Këtu urdhëro, pagoni cash.
Zoti Ruh, unë nuk kam lekë!
Atëhere po e vëmë këpucën këtu,
sepse për klientë pa lekë
nuk kam sot terezi.

Mirëdita, zoti Ruh.
Mirëdita, zonja pa-këpuc.

Kopshti



Mbas disa jave në kopsht, fëmijët e njohin dhomën e grupit, njihen me fëmijët e tjerë dhe me edukatorët e kopshtit.

Kopshti ka disa dhoma. Në fillim fëmijët duhet të dinë rugën nga dhoma e tyre për në banja, më pas fëmijët mësojnë dhomat e tjera dhe sheshin e lodrave. Hap mbas hapi ata eksplorojnë të tërë godinën. Në qoftëse fëmija ka një vëlla ose një motër më të ritur në këtë kopsht atëhere ai do orientohet më lehtë.

Dhe për ju ka shumë gjëra për të parë në ndërtesën e kopshtit. Vetëm nga pamja e godinës ju mund të ndjeni atmosferën që egziston atje.

Kujdesuni për këto gjëra:

- Shikoni si duket godina.
- A janë varur piktura në mur?
- Janë fëmijët nëpër koridore duke u marrë me një gjë?
- Janë dyert e grupeve të hapura?
- Ka diçka që ju pëlqen?

Ju mund të flisni për këto gjëra me fëmijën tuaj:

- Si duken koridoret?
- Si duket dhoma e lodrave?
- Ka ndryshime midis grupeve?
- Si quhen grupet e tjera?
- Ka një dhomë për fëmijët që shkojnë në shkolle?
- Ka një çerdhe për bebet?

Flisni me fëmijën tuaj për eksperiencat tuaja kur ju ishit në moshën e tij, mundohuni të kujtoheni.

Çfarë keni lozur juve në moshën e tij?

Bëfshi shumë qef në kopsht!

JAVA 1: KOPSHTI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqet 26 dhe 27 e fletëve të ushtrimeve,
- Ndoshta disa lapsa me ngjyra..

Fëmija juaj mëson:

të flasi për një figurë.

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për emrin e kopshtit dhe shkruani atë të kutija që është bosh në faqen 26. Vazhdoni të flisni, për shëmbull: “Ku po shkojnë fëmijët?”, “Kush po i çon ata atje?”, “Çfarë kanë fëmijët në dorë?”, e kështu me radhë.
- Lëreni fëmijën tuaj t’ju tregojë një eksperiencë të tij në kopsht të cillën figura ja kujton.
- Lëreni fëmijën tuaj të vizatojë një zile, një kuti poste dhe një penxhere në faqen 27.

Detyra shtesë:

- Shikoni bashkë me fëmijën tuaj për gjëra që mundën të hapen dhe të mbyllen prapë (për shëmbull një penxhere, një derë, një kanoçe, një xhup, e kështu me radhë)
- Mendohuni bashkë çfarë gjërash keni në shtëpi që janë për tu rutulluar, për tu mbyllur, tu mbyllur duke kërcitur, për tu vidhosur, që mbyllen me komça dhe që shtypen.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit)

Detyrë shtesë:

- Flisni me fëmijën për ditën e tij në kopsht, për shëmbull “Çfarë të pëlqevi sot më shumë?”, “Çfare nuk të pëlqevi? Pse?”, “Mungovi sot ndo njëri? Kush?”, e kështu me radhë.

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 28 e fletëve të ushtrimeve,
- Një laps.

Fëmija juaj mëson:

Të përshkruaj rugën për në kopsht.

Detyrat:

- Duke shkuar me fëmijën tuaj për në kopsht flisni për rugën.
- Ndëroni rolet: Fëmija është mamaja dhe mamaja bëhet fëmija. Pyeteni fëmijën tuaj ku mundet ta kaloni rugën, ku është semafori dhe ku janë vizat e bardha.
- Lëreni fëmijën tuaj ta përshkruajë rugën nga shtëpia për në kopsht dhe ta vizatojë atë në faqen 28. Gjatë kësaj ju mund ti bëni atij pyetje, për shëmbull: “Sa rugë duhet të kalosh ti (numuroini bashkë)?”, “Çfarë shikon ti rugës për në kopsht?” (Qëllimi nuk është që të vizatoni një hartë ekzakte të qytetit!).

Dita 4

Fëmija juaj mëson:

Të përshkruajë rugë,
emrin, adresën dhe numrin e telefonit.

Detyrat:

- Flisni për rugë të tjera, për shëmbull për tek tregu, për tek gjyshja, e kështu me radhë.
- Flisni me fëmijën për mundësinë që ai të ngatrohet dhe për çfarë duhet të bëjë ai në një rast të tillë. Ushtroni bashkë emrin, adresën dhe numrin e telefonit.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 29 e fletëve të ushtrimeve,
- Një laps me ngjyrë jeshile.

Fëmija juaj mëson:

të njohi reziqet e trafikut të rugës,
si ta kalojë rugën në mënyrën më të sigurt.

Detyrat:

- Shpjegojini fëmijës tuaj çfarë duhet të ketë kujdes kur kalon rugën. I thoni atij për shëmbull: “Shiko njëherë majtas, pastaj djathtas dhe në fund prapë njëherë majtas”. Nëqoftse e përsërisni këtë shpesh, dhe fëmija mundet pothuajse ta këndojë, ka për ta bërë këtë dhe kur të kalojë rugën.
- Lëreni fëmijën tuaj të flasi për figurën në faqen 29.
- Lëreni fëmijën ta vizatojë semaforin me ngjyrë jeshile tek faqia 29, dhe flisni me atë për kuptimin e ngjyrave jeshile, e verdhë dhe e kuqe tek një semafor.

Detyra shtesë:

- Përsëriteni vjershën deri sa fëmija juaj të dijë ta thotë atë. Kështu fëmija mëson si të mbajë mënt gjërat.
- Flinsni rugës për në kopsht për rregullat e trafikut të rugës.

GEDICHT

Ein Apfel wollte wandern gehen,
er konnte Autos fahren sehen,

zur ander’n Seite hat er’s nicht
geschafft,
tuut, tuut – schon war er Apfelsaft!

VJERSH

Një mollë deshte të bënte një shëtitje,
ajo mund të shikonte makinat duke
ecur,

në anën tjetër të rugës ajo nuk ariti të
shkonte,
Tuut, tuut- dhe ajo u bë lëng molle!



JAVA 2: KOPSHTI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 30 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë.

Fëmija juaj mëson:

Ndryshimin e robave të verës me robat e dimrit,
fjalët *ftohtë*, dhe *ngrohtë*, i kënaqur dhe i *mërzitur*.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj që të flasi për robat që mban në verë dhe në dimër. Përdorni për këtë punë shpesh fjalët *ngrohtë* dhe *ftohtë*.
- Lëreni fëmijën të vizatoj një fytyrë të kënaqur dhe një fytyrë të mërzitur në faqen 30.
- Lëreni fëmijën të tregojë pse një fytyrë duket e mërzitur dhe tjetra e kënaqur.

Detyrë shtesë:

- Këndoni me fëmijën tuaj këngën:

LIED

Grün, grün, grün sind alle meine Kleider.
Grün, grün, grün ist alles, was ich hab'.
Darum lieb' ich alles, was so grün ist,
weil mein Schatz ein Jäger, Jäger ist.

Blau, blau, blau sind alle meine Kleider.
Blau, blau, blau ist alles, was ich hab'.
Darum lieb' ich alles, was so blau ist,
weil mein Schatz ein Matrose ist.

Weiß, weiß, weiß sind alle meine Kleider.
Weiß, weiß, weiß ist alles, was ich hab'.
Darum lieb' ich alles, was so weiß ist,
weil mein Schatz ein Bäcker, Bäcker ist.

Bunt, bunt, bunt sind alle meine Kleider.
Bunt, bunt, bunt ist alles, was ich hab'.
Darum lieb' ich alles, was so bunt ist,
weil mein Schatz ein Malermeister ist.

KËNGA

Jeshile, jeshile, jeshile, janë tërë robat e mia.
Jeshile, jeshile, jeshile, janë të tëra gërat që unë kam.
Prandaj unë dua çdo gjë që është kaq jeshile,
se buri im është gjahtar, gjahtar.

Blu, blu, blu, janë tërë robat e mia.
Blu, blu, blu, janë të tëra gërat që unë kam.
Prandaj unë dua çdo gjë që është kaq blu,
se buri im është marinar.

E bardhë, e bardhë, e bardhë, janë tërë robat e mia.
E bardhë, e bardhë, e bardhë, janë të tëra gërat që unë kam.
Prandaj unë dua çdo gjë që është kaq e bardhë,
se buri im është bukëpjekës, bukëpjekës.

Ngjyra-njyra, ngjyra-njyra, janë tërë robat e mia.
Ngjyra-njyra, ngjyra-njyra,, janë të tëra gërat që unë kam.
Prandaj unë dua çdo gjë që është kaq ngjyra-njyra,,
se buri im është bojaxhi.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashk një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit)

Detyrë shtesë:

- Flisni me fëmijën tuaj për edukatorët e kopshtit dhe kopshtin, për shëmbul “Si e ka emrin kujdestari/kujdestarja jote?”, “Si e ka emrin kujdestari/kujdestarja e grupit tjetër?”, “Çfarë bëni ju në dhomën e fiskulturës?”, e kështu me radhë.

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 31 e fletëve të ushtrimeve,
- Një laps me ngjyrë të kuqe dhe të verdhë,
- Një çantë kurizi,
- Një gotë,
- Diçka për të ngrënë.

Fëmija juaj mëson:

çfarë duhet të mari me vete në kopsht, emrtimin, robat e verës dhe të dimrit.

Detyrat:

- Diskutoni cilat gjëra do ishte mirë që fëmija ti merte me vete për në kopsht, për shëmbull:
 - diçka për të ngrënë për pushimin e mëngjesit,
 - roba sportive,
 - shami hunde,
 - e kështu me radhë.
- Lëreni fëmijën të pregatiti një çantë kurizi për kopshtin me gjëra për të ngrënë dhe për të pirë në pushimin e mëngjesit.

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën ti vizatojë robat e dimrit me të kuqe dhe robat e verës me të verdhë në faqen 31.

Dita 4

Fëmija juaj mëson:

të dëgjojë me vëmendje, të reagojë në mënyrën e përshtatshme dhe të orientohet në një dhome.

Detyra:

- Lozni “LOJA-NGROHT-FTOHT”

DAS "WARM-KALT-SPIEL"

Verstecken Sie Spielzeug, wenn Ihr Kind nicht zusieht.

Lassen Sie Ihr Kind dieses Spielzeug suchen.

Wenn es in dessen Nähe kommt, rufen Sie „Warm, warm, wärmer...“, wenn es in die falsche Richtung geht, rufen Sie „Kalt, kalt, kälter...“.

"LOJA-NGROHT-FTOHT"

Fshihni disa lodra kur fëmija juaj nuk është duke parë.

Lëreni fëmijën tuaj ti kërkojë këto lodra.

Kur ai ju afrohet atyre, thërisni "Ngroht, ngroht, akoma më ngroht...", nëqoftëse është duke shkuar në dretimin e gabuar, thërisni "Ftoht, ftoht, akoma më ftoht..."

Detyrë shtesë:

- Përsërisni me fëmijën tuaj emrin e tij, adresën dhe numrin e telefonit të tij.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqet 32 dhe 33 të fletëve të ushtrimeve,
- Një reklamë lodrash,
- Një gërshtë,
- Ngjitës.

Fëmija juaj mëson:

fjalët *njësoj* dhe *ndryshe*,

ndryshimin midis lodrave për *brënda* dhe *jashtë* shtëpisë.

Detyra:

- Lëreni fëmijën tuaj të kërkojë katër ndryshime në faqen 32.
- Lëreni fëmijën tuaj të presi figurat e lodrave nga një reklamë.

- Lëreni fëmijën tuaj ti vëri bashkë lodrat me të cilat lozet brënda në shtëpi, dhe lodrat me të cilat lozet jashtë shtëpisë. Me cilat lodra lozet brënda dhe përjashta?

Detyra shtesë:

- Lëreni fëmijën të kërkojë për figura që janë njësoj në faqen 33.
- Tregojini fëmijës tuaj me çfarë keni lozur ju kur keni qënë të vegjël. Mos haroni rërën dhe ujin.

JAVA 3: KOPSHTI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 34 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë.

Fëmija juaj mëson:

ta ketë vëmendjen për gjërat reth e rotull tij,
të flasi për gjërat reth e rotull tij.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj të flasi për kopshtin, për shëmbull “Ku është grupi jot?”, “Sa kate ka kopshti?”, “Sa grupe ka në kopsht?”, “Ku loz ti përjashta?”, “Ku është dhoma e fiskulturës?”, e kështu me radhë.
- Lëreni fëmijën tuaj të bëjë një vizatim të kopshtit të tij në faqen 34.

Dita 2

Detyra:

- Shikoni bashkë një libër me figura dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit)

Detyrë shtesë:

- Flisni me fëmijën tuaj për kopshtin.
- Flisni me fëmijën tuaj, si festohen ditëlindjet në kopsht.
- Tregojini fëmijës tuaj si i keni festuar ju ditëlindjen tuaj kur ishit fëmijë.

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 35 dhe 36 e fletëve të ushtrimeve,
- Një gërshtë,
- Ngjitës.

Fëmija juaj mëson:

të ngjisi tamam,
të bashkojë pjeset e një gjëje që janë të ndara.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj ti presi figurat tek faqia 35.
- Lëreni fëmijën tuaj të bëjë një figur të përbashkët prej figurave të sapo prera dhe ta ngjisi atë mbi karocerinë e makinës në faqen 36.

Dita 4

Fëmija juaj mëson:

të njohi dhe të përshkruaj semaforë të ndryshëm.

Detyra:

- Bëni një shëtitje me fëmijën tuaj dhe shikoni për semaforët e ndryshme. Flisni me fëmijën tuaj për ndryshimin e një semafori për makinat dhe një semafori për këmbësorët.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 37 e fletëve të ushtrimeve,

Fëmija juaj mëson:

Parafjalët *sipër*, *poshtë*, *mbrapa*, *përpara*, *brënda* dhe *përgjithësisht*,
një këngë të re.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj të përshkruajë, midis figurave në faqen 37 se ku është macja ose qeni.
- Ushtroni dhe fjalitë e kundërta me fëmijën:
 - Macja është posht tavolinës.
 - Macja është përpara dollapit.
 - Qeni është përpara kasolles.
- Lëreni fëmijën pastaj t'ju tregojë (me gisht) se ku janë macja dhe qeni.

Detyrë shtesë:

- Këndoni bashkë me fëmijën tuaj këngën dhe përdorni dhe fjalë të tjera, për shëmbull:
- Kush nuk do të vizatojë..., ai ulet.
- Kush nuk do të ngjisi..., ai ulet.
- Kush nuk do të kërcejë..., ai ulet.
- Kush nuk do të lozi..., ai ulet.
- Kush nuk do të notojë... ai ulet.

LIED

Wer nicht laufen will,
wer nicht laufen will,
der setzt sich.

Wer nicht laufen will,
wer nicht laufen will,
der setzt sich.

KËNGË

Kush nuk do të vrapojë,
kush nuk do të vrapojë,
ai ulet.

Kush nuk do të vrapojë,
kush nuk do të vrapojë,
ai ulet.

Grupi



Në grupin e kopshtit fëmijët lozin për herë të parë pa praninë e mamave të tyre. Prandaj edukatorët bëhen një person i rëndësishëm për fëmijët dhe kështu edhe për ju. Në grup fëmijët duhet ta ndiejnë veten të sigurtë. Dhomat e grupit organizohen në mënyrë që ti ndihmojnë fëmijët që të zhvillohen.

Dhoma e grupit shpesh është e ndarë në qoshe të ndryshme dhe grupe tavolinash. Në secilën nga këto zona fëmijët mundet të bëjnë gjëra të ndryshme.

Në një kopsht mundet të gjeni këto zona lodrash:

- qoshen e kukllave,
- qoshen e ndërtimit,
- qoshen e lezimit,
- qoshen e vizatimit,
- pazarin,
- e kështu me radhë.

Në kopsht mundet të gjeni dhe tavolina të ndryshme:

- tavolinën e vizatimit,
- tavolinën e mëngjezit,
- Tavolinën e punës e kështu me radhë

Jo të tërë kopshet e kanë këtë lloj ndarje. Ka dhe disa kopshte në të cilët mundet të bëhen disa gjëra në një tavolinë.

Do ishte mirë nëqoftse mundet ta shikoni bashkë me fëmijën tuaj kopshtin e tij. Kështu ju mundet të shikoni nëqoftse në grupin e fëmijës tuaj ekziston e njëjta ndarje. Ju mundet të flisni me fëmijën tuaj për zonat e ndryshme të lojrave.

Mbas disa javëve fëmija juaj njih shumë nga regullat dhe marveshjet e grupit. Regulla dhe marveshje i japin fëmijës tuaj mundësinë të jetë i pa varur. Kjo pavarësi i jep fëmijës tuaj besim në veten e tij.

Shikoni njëherë për disa orë punën që bëhet në grupin e fëmijës tuaj. Pyeteni shoqeruesen e prindërve ose edukatorët për këtë.

Bëfshi shumë qef në kopsht!

JAVA 1: GRUPI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 39 e fletëve të ushtrimeve,
- Një laps me ngjyrë të kuqe,
- Një laps me ngjyrë blu.

Fëmija juaj mëson:

të ushtrojë kujtesën dhe perceptimin e tij,
ngjyrat *e kuqe* dhe *blu*,
fjalët *perlë* dhe *varse*.

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për materialet me të cilat fëmija juaj luan në kopsht, për shëmbul “Çfarë ka në qoshen e kukllave”, “Me çfarë mund të lozësh ti përjashta?”, “Çfarë mund të bësh ti në tavolinë?”, “Me çfarë loz ti në dhomën e lodrave?”.
- Lëreni fëmijën tuaj të vizatojë perlat e varses në faqen 27. Perlën e parë blu, të dytën me të kuqe, të tretën prapë blu e kështu me radhë.

Detyra shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të shikojë stoli të ndyrshme, për shëmbul një varse, një unazë dhe një varse dore.
- Ndërtoni me fëmijën tuaj një varse prej perlave, kopsave ose makarornave.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysht dhe udhëzimet e librit)

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të flasi për gjërat që janë të vjetra dhe për gjërat që janë të reja, për shëmbull në shtëpinë tuaj, në dollapin e robave, e kështu me radhë.
- Lëreni fëmijën tuaj t’ju tregojë të tëra gjërat e rumbullakta në dhomën e ndenjes.

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 40 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë,
- Gjëra që janë të rumbullakta, katrore, trekëndshe ose kuadratike.

Fëmija juaj mëson:

format e rumbullakt, katrore, trekëndshe dhe kuadratike.

Ngjyrat *jeshile*, e *kuqe*, *blu* dhe e *verdhë*.

Detyrat:

- Kërkoni me fëmijën tuaj gjatë rugës për në kopsht forma të rumbullakta, katrore, trekëndshe dhe kuadratike, për shëmbull dritare, tabelat e qarkulimit rugor, e kështu me radhë. Bëni lojën e kërkimit të tyre, dhe flisni me fëmijën tuaj për format e ndryshme, për shëmbull: “Është kjo dritare katrore apo kuadratike?”.
- Lëreni fëmijën tuaj ti vizatojë format në faqen 40: kuadratet me të kuqe, trekëndshet me jeshile, rathët me të verdhë dhe katroret me blu.

Detyrë shtesë:

- Lini një termin me kopshtin dhe vini re atje se si sillet fëmija juaj në grupin e tij.

Dita 4

Ju duhet:

- Plastelinë, brum ose fije leshi.

Fëmija juaj mëson:

t ë krijojë vetë forma të rumbullakta, katrore, kuadratike dhe trekëndshe.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj të fëmijën tuaj të formojë me plastelinë, brumi ose fije leshi kuadrate, katrore, rathë ose trekëndshe.

Detyrë shtesë:

- Flisni me fëmijën tuaj për çfarë ai ka bërë në kopsht, për shëmbull:
 - “Cilat këngë keni kënduar ju?”

- “Ju lexovi edukatori/edukatorja diçka?”
- “Çfarë ju lexovi edukatori/edukatorja?”

Dita 5

Ju duhet:

- Faqet 41, 42 dhe 43 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra.

Fëmija juaj mëson:

të thotë çfarë po shikon.

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për figurën në faqen 41.
- Lëreni fëmijën tuaj të kërkojë katër ndryshime në faqen 42.

Detyrë shtesë:

- Vizatoni figurat e faqes 43 në një letër të fortë dhe prijin ato. Lëreni fëmijën ti kopjojë këto figura në një fletë të re letre. Kjo detyrë mundet të bëhet edhe me një tas të rumbullaktë dhe me një formë katrore.

JAVA 2: KOPSHTI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 44 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra.

Fëmija juaj mëson:

të ushtrojë kujtesën e tij,
të gjejë figura që shkojnë me njëra tjetrën.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj të thotë emrin e fëmive të tjerë të grupit. Ai duhet të thotë edhe sa vjeç ata janë, nëqoftse janë djem ose vajza e kështu me radhë.

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën të bashkojë me viza figurat që shkojnë bashkë në faqen 44:
 - Babi shkon me mamin,
 - Çorapja shkon me këpucën,
 - Lulja shkon me vazon,
 - Kova shkon me lopatën.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit.)

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 45 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra.

Fëmija juaj mëson:

të tregojë si duket dhoma e grupit të tij.

Detyra:

- Lëreni fëmijën tuaj të vizatojë në faqen 45 gjëra nga dhoma e grupit të tij. Juve mund të bëni pyetje në bazë të figurës, për shëmbull “Ka kukulla këndi i kukullave?”, “Ku janë gurët e ndërtimit?”, “Ka roba për tu maskuar?”, e kështu me radhë.

Detyrë shtesë:

- Pyeteni fëmijën tuaj çfarë ka bërë ai sot në kopsht.

Dita 4

Ju duhet:

- Gjëra të rumbullakta, katrore dhe trekëndshe nga shtëpia juaj,
- Një qese prej robe ose plastike jo të tejdukshme

Fëmija juaj mëson:

të ndjejë forma të ndryshme dhe t’ju thotë atyre emrin.

Detyra:

- Futini gjërat në qesen prej robe ose plastike. Lëreni fëmijën tuaj të gjejë një gjë kuadratike, katrore, të rumbullaktë ose trekëndshe, duke e prekur qeskën, pa e parë se çfarë ajo ka brënda. I thoni fëmijës tuaj: “Më jep diçka të rumbullaktë!”, “Më jep diçka kuadratike!” e kështu me radhë. Lëreni dhe fëmijën tuaj të kërkojë diçka që ju duhet ta gjeni.

Detyrë shtesë:

- Flisni me fëmijën tuaj për stoli, që vin nga shteti juaj. Kushtoini vëmëndje sindomos formave dhe ngjyrave.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 45 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra,
- Një gërshërë,

Fëmija juaj mëson:

të vizatojë,
të presi,
të lozi me puzzle,

të shikojë ekzakt.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj ti ngyrosi figurat në faqen 46. Pastaj priteni figurën tek vizat e trasha, kështu ajo bëhet një puzzle.
- Lëreni fëmijën tuaj ta ndërtojë puzzlen.

Detyrë shtesë:

- Lozni lojën “Kimspiel” me këto gjera:
 - një perlë,
 - një puzzle,
 - diçka të rumbullaktë,
 - diçka kuadratike.

JAVA 3: KOPSHTI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 47 e fletëve të ushtrimeve,

Fëmija juaj mëson:

të shprehi mendimet e tij,
të krijojë lidhje ndërmjet figurave.

Detyrat:

- Flisni bashkë me fëmijën tuaj për figurën në faqen 47.
- Bëni këto pyetje: “Çfarë janë fëmijët duke bërë?”, “Çfarë po përdorin ata për atë punë?”, “Si duken vizatimet e fëmijve?”.

Detyra shtesë:

- Lozni lojën e papagallit me këto fjalë:
puzle, ndërton, mozaik, ngjit, vizaton, ngjyros, vizë, pik.
- Lozni lojën e papagallit me fjalë më të vështira:
Penel, për shëmbull Peneli i piktorit: “Njeh ti dhe penela të tjer?”
Letër, për shëmbull Letër me ngjyrë: “Njeh ti dhe fjalë të tjera me letër?”
(për shëmbull letër higjenike, letër vizatimi, e kështu me radhë) Kukulla,
për shëmbull këndi i kukullave: “Njeh ti dhe fjalë të tjera me kukulla?”
(për shëmbull fustani i kukullës, karoca e kukullës, e kështu me radhë)

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit.)

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 48 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra ose bojra uji,

Fëmija juaj mëson:

të masi dhe të vizatojë në mënyrë të pasqyruar. Të vizatosh në mënyrën e pasqyruar është shumë e vështirë, nëqoftse fëmija juaj nuk arin ta bëjë këtë nuk prish punë.

Detyra:

- Lëreni fëmijën tuaj ta ngjyrosi krahun e djathtë të fluturës në faqia 46 në të njëjtën mënyrë si krahun e majtë.

Detyrë shtesë:

- Lozni me fëmijën tuaj lojën e papagallit. Juve thoni një fjalë dhe fëmija juaj thotë të kundërtën:
 - Jo e madhe, por... (e vogël)
 - Jo e bukur, por... (e shëmtuar)
 - Jo e pastër, por... (e pistë)
 - Jo e trashë, por... (e hollë)
 - Jo një i djalë, por një... (vajzë)
 - Jo e gjatë, por... (e shkurtër)

Dita 4

Ju duhet:

- Faqet 49 dhe 50 e fletëve të ushtrimeve.

Fëmija juaj mëson:

të kategorizojë figura që janë njësoj.

Detyra:

- Lëreni fëmijën ti ngjyrosi figurat në faqet 49 e 50 dhe ti presi ato pastaj. Lozni me ato lojën “Memory”.

Dita 5

Fëmija juaj mëson:

një këngë të re,
një lojë për të zhvilluar preceptim dhe aftësinë e koncentrimit të tij.

Detyrat:

- Këndoni me fëmijën tuaj këngën dhe përsëriteni bashkë.
- Lozni bashkë me fëmijën tuaj lojën “Unë shikoj çfarë ti nuk sheh

LIED

Wer nicht laufen will,
wer nicht laufen will,
der setzt sich.

Wer nicht laufen will,
wer nicht laufen will,
der setzt sich.

KËNGË

Kush nuk do të vrapojë,
kush nuk do të vrapojë,
ai ulet.

Kush nuk do të vrapojë,
kush nuk do të vrapojë,
ai ulet.

Detyra shtesë:

- Këndoni bashkë me fëmijën tuaj këngën dhe përdorni dhe fjalë të tjera, për shëmbull:
 - Kush nuk do të vizatojë..., ai ulet.
 - Kush nuk do të ngjisi..., ai ulet.
 - Kush nuk do të kërcejë..., ai ulet.
 - Kush nuk do të lozi..., ai ulet.
 - Kush nuk do të notojë... ai ulet.
- Lëreni fëmijën tuaj të flasi për gjëra që janë të forta dhe të buta.

Të lozësh jashtë



Çdo fëmijë ka krijuar eksperiencat e tij duke luajtur jashtë shtëpisë. Kjo temë ofron shumë mundësira për të ndërmarë diçka me fëmijën tuaj. Për shëmbull ju mund të shkoni në sheshin e lodrave, në park ose në pyll.

Në këtë temë do diskutoen këto forma për të luajtur përjashta:

- të luash në rugë,
- të luash në mes të shiut,
- të luash me zara prej qelqi,
- të luash në pyll,

Ju mundeni dhe të tregoni si keni luajtur ju kur ishit fëmijë, në vëndin nga i cili vini. Dhe ju mundeni ta shikoni fëmijën tuaj si luan përjashta: Luan me fëmijë të tjer apo vetëm? Luan me ose pa lodra? Zihet fëmija juaj me fëmijët e tjerë në rugë, dhe nëqoftëse po, pse?

Bëfshi shumë qef duke luajtur përjashta!

JAVA 1: TË LOZËSH JASHTË

Dita 1

Ju duhet:

- Faqet 52 dhe 53 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë.

Fëmija juaj mëson:

të dëgjojë tamam,
të krijojë lidhje midis lojëve dhe lodrave respektive.

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për figurën në faqen 52.
- Lëreni fëmijën tuaj ti lidhi situationet e lojëve në faqen 53 me lodrat respektive.
- Kërkoni me fëmijën tuaj fjalë fantazie ose të rimoni me këto fjalë: makina, rërë, ruga, xhupi, e pistë, e shpejt.

Detyra shtesë:

- Bëni një xhiro me biçikletë me fëmijën tuaj dhe tregoni çfarë po shikoni përjashta.

SHËNIM

Tema fillon me figurën në faqen 52 të fletëve të ushtrimeve. Këtë figurë ju mundet ta përdorni për të folur për lojrat që bëhen përjashta. Ju mundet dhe ta lini fëmijën që të thotë çfarë ai është duke parë. Simbas figurës ju mundet të bëni pyetje. Sidomos bëni pyetje që fillojnë me çfarë, ku dhe pse. Nëqoftse fëmija jua do ta ngjyrosi figurën, ju mund të flisni gjatë kësaj kohe në lidhje me çfarë ai po ngjyros.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit)

Detyrë shtesë:

- Shkoni me fëmijën tuaj në një bibliotekë.

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 54 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë,
- Katër objekte të ndryshme.

Fëmija juaj mëson:

ndryshimin midis e *madhe* dhe e *vogël*.

Detyrat:

- Flisni në lidhje me katër objektet çfarë është e *madhe* dhe çfarë e *vogël*.
- Lëreni fëmijën tuaj ti vizatojë gjërat e mëdhaja në faqen 54 jeshile dhe gjërat e vogla me të verdhë.

Detyrë shtesë:

- Rugës për në kopsht lëreni fëmijën tuaj të thotë emrin e gjërave të mëdhaja dhe të vogla.
- Pyeteni fëmijën tuaj me çfarë ai luan përjashta.

Dita 4

Fëmija juaj mëson:

t ë zhvillojë aftsitë e tij motorike.

Detyra:

- Dilni me fëmijën tuaj jashtë dhe luani një lojë që ai njeh, për shëmbull “Hüpfkästchen”, “Seilspringen”, “Gummitwist” e kështu me radhë.

Detyrë shtesë:

- Këndoni një këngë nga vëndi që ju vini.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 55 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra.

Fëmija juaj mëson:

ngjyrat e *kuqe*, *jeshile*, e *verdhë* dhe *blu*,
formën e rethit
fjalët e *madhe* dhe e *vogël*.

Detyra:

- Lëreni fëmijën ti vizatojë rathet në faqen 55. Rathet e mdhenj me të kuqe, rathet pak më të vogla jeshile, akoma më të voglat me të verdhë dhe të vegjlit fare me blu, për shëmbull: “Trego njëher tek rethi më i madh. Ka dhe rathë të tjerë të mdhenj? Rathet më të mëdhenj mund ti vizatosh me të kuqe. Cilat janë tashti rathet më të mëdhenj? Tregoi ato. Këto mund ti vizatosh me jeshille tashti”.

Detyrë shtesë:

- Krasoni me fëmijën tuaj madhësinë e çorapeve të pjestarve të familjes. Lëreni fëmijën të gjejë cilat çorape i takojnë çdonjërit.

JAVA 2: TË LOZËSH JASHTË

Dita 1

Ju duhet:

- Faqet 56 dhe 57 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra,
- Një gërsërë.

Fëmija juaj mëson:

të lozi si mbas regullave,
tju thotë emrin gjërave që shikon.

Detyra:

- Pritini tek vizat e ndërprera figurat në faqet 56 dhe 57 me fëmijën tuaj dhe lëreni ti bashkojë çiftet e figurave.

Detyra shtesë:

- Ndërtoni me fëmijën tuaj një lojë “Memory”. Për ti përforcuar figurat e prera, ngjitini ato në një copë kartoni.
- Luani bashkë lojën “Memory”.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit.)

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 58 e fletëve të ushtrimeve,
- Një Laps.

Fëmija juaj mëson:

Emërtimin e pjesëve të ndryshme të biçikletës.

Detyra:

- Lëreni fëmijën tuaj të kërkojë pjesët që i mungojnë biçiklets në faqen 58 dhe ti vizatojë ato.

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të shikojë një biçiklet dhe t'ju thotë emrin pjesve të ndryshme. Lëreni dhe që të thotë për çfarë shërbejnë ato pjesë.

Dita 4

Ju duhet:

- Shkumës që shkruan në rugë.

Fëmija juaj mëson:

të përdori shkumës,
të vizatojë në fusha të mëdhaja.

Detyra:

- Dilni më fëmijën tuaj përjashta dhe vizatoni me shkumës në rugë.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 59 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra.

Fëmija juaj mëson:

të krijojë lidhje midis figurave.

Detyrat:

- Shikojini bashkë me fëmijën tuaj figurat në faqen 59 dhe flisni për çfarë ka ndodhur.
- Lëreni fëmijën tuaj të lidhi me një vijë një figurë dhe një objekt që shkon me të.

Detyra shtesë:

- Flisni me fëmijën tuaj për gjëra që janë të lagura ose të thata.
- Fusni në një kuti një arush loje, një top dhe një litar dhe lëreni fëmijën tuaj me sy të mbyllura ti preki ato dhe të tregojë çfarë janë.

JAVA 3: TË LOZËSH JASHTË

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 60 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra,
- Një laps i zi.

Fëmija juaj mëson:

të krahasojë me vëmendje

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj ti bashkojë të njëjtat çorape dhe këpucë me njëra tjetrën në faqen 60.
- Dilini me fëmijën tuaj përjashta dhe gjeni dy gjëra që janë njësoj, për shëmbull gjethe peme, gurë, shkopinj dhe kështu me radhë.

Detyrë shtesë:

- Mbushni një qese me gjërat e mbledhura dhe lëreni fëmijën tuaj të gjejë dy gjëra që janë njësoj duke i prekur ato, dhe pastaj ti nxieri ato nga qesja.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit.)

Dita 3

Fëmija juaj mëson:

të orientohet përjashta.

Detyra:

- Dilni me fëmijën tuaj jashtë dhe luani me atë lojën kukamçefiti.

Dita 4

Ju duhet:

- Faqia 61 e fletëve të ushtrimeve.

Fëmija juaj mëson:

të flasi dhe të provojë lëvizje të ndryshme.

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për figurën në faqen 61.
- Mendohuni me fëmijën tuaj që si mund të lëvizësh, për shëmbull duke u hedhur, duke vrapuar, duke kërcyer e kështu me radhë. Provohini këto bashkë. Vini re cilat lëvizje fëmija juaj i bën lehtë dhe cilat me më shumë vështirësi. Çfarë bën ai me qef dhe çfarë nuk i pëlqen? Mundet të rijë vetëm në një këmbë fëmija juaj?

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 62 e fletëve të ushtrimeve,
- Një top pehu, ose një litar i gjatë,
- Lapsa me ngjyra.

Fëmija juaj mëson:

të mbajë ekuilibrin e tij.

Detyra:

- Dilni me fëmijën tuaj jashtë dhe shtroni një pjese ruge perin ose litarin, mbi të cilin ju dhe fëmija juaj duhet të ecni duke mbajtur ekuilibrin. Ndrojeni lojën me të kërcyer, me të vrapuar, e kështu me radhë.

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj ti ngjyrosi në çdo rjesht figurat që janë njësoj në faqen 62.

Lëvizja



Fëmijët e vegjël kanë shumë energji për të lëvizur. Fëmijet duan të zbulojnë botën rreth tyre dhe të gjejnë mundësitë dhe kufizimet e tyre të ndryshme.

Sa më shumë ata rriten, aq më shumë dhe lëvizjet që bëjnë ata i kanë dhe më të thjeshta. Ata provojnë gjithmonë lëvizje dhe më të vështira.

Për fëmijët e vegjël është shumë e vështirë të kërcëjnë me litar, por nëqoftëse ata arrijnë ta bëjnë njëherë, atëherë ata shpejt provojnë dhe kërcime më të vështira.

Kur vizatojnë ata bëjnë lëvizje të mëdhaja dhe ata lozin me gurë ndërtimi të mëdhenj.

Fëmijë më të ritur mundet të bëjnë lëvizje me më shumë saktësi, si për shëmbull të ngjyrosin ose të presin një figurë gjatë një vize.

Për lëvizjet kryesore motorike mendoni për shëmbull:

- të hecësh me biçikletë,
- të vraposh,
- të ngjitesh lart në një vënd,
- të kërcësh si mbas muzikës,
- të bësh muzik me një daulle dhe shkopa.

Për lëvizje motorike fine mendoni për shëmbull:

- të presësh diçka me një gërshërë,
- të ngjyrosësh,

- të çposh,
- të mbushësh një gotë me lëng,
- të lidhësh këpucët,
- të kopsitësh një këmishë.

Disa herë lëvizja është një nevojë. Për të dalë përpara për shëmbull duhet të hecësh. Disa herë lëvizja bën qef.

Lëvizni shumë dhe me shumë qef!

JAVA 1: LËVIZJA

Dita 1

Ju duhet:

- Faqet 64 dhe 65 e fletëve të ushtrimeve,
- Muzikë kërcimi.

Fëmija juaj mëson:

të shikojë tamam në figurë,
të medohet për një figurë që ka parë,
të gjejë arsye për diçka.

Detyrat:

- Bëni shkurt disa komente të gabuara për figurën në faqen 64, për shëmbull “Këtu po kërcen një djalë”, “Vajza po kërcen me një ari” e kështu me radhë. Vini re si reagon fëmija juaj. Arin ai ti gjejë gabimet? Pyeteni fëmijën tuaj çfarë po ndodh me të vërtetë tek figurat dhe lërojani atij t’ja u shpjegojë juve ngjarjen.
- Dëgjoni me fëmijën tuaj melodi të ndryshme dhe kërceni me to. Kërcen fëmija juaj për meloditë e ndryshme në mënyra të ndryshme?
- Lëroni fëmijën tuaj ti ndjekë vizat në faqen 65 dhe të gjejë me çfarë po loz djali.

Detyra shtesë:

- Këndoni bashkë këngën “Kopf, Schuler, Knie und Zehen” (“Kokë, Shpatulla, Gjunjë dhe Gishtat e Këmbës”).

LIED

Kopf, Schulter, Knie und Zehen,
Knie und Zehen,
Kopf, Schulter, Knie und Zehen,
Knie und Zehen,
Augen, Ohren, Nasenspitze,
Kopf, Schulter, Knie und Zehen,
Knie und Zehen,

KËNGË

Kokë, shpatulla, gjunjë dhe gishtat e këmbës
Gjunjët dhe gishtat e këmbës,
Kokë, shpatulla, gjunjë dhe gishtat e këmbës
Gjunjët dhe gishtat e këmbës,
Sy, veshë, maja e hundës,
Kokë, shpatulla, gjunjë dhe gishtat e këmbës
Gjunjët dhe gishtat e këmbës,

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit)

Detyrë shtesë:

- Kërceni me fëmijën tuaj një valle nga vëndi që ju vini.
- Persërisni këngën nga dita e parë.

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 66 e fletëve të ushtrimeve,
- Dy lugë prejë druri,
- Lapsa me ngjyrë.

Fëmija juaj mëson:

Fjalët *shpejt* dhe *avash*.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj të bëjë zhurma me lugën prej druri, për shëmbull: këndon bashkë një këngë të thjeshtë dhe lëreni atë të mbajë ritmin me lugën. Trokisini me majat e gishtave në tavolinë sikur po bije shi, në fillim lehtë fare, pastaj një çik me fortë dhe pastaj fortë fare.
- Duartrokisni bashkë avash fare, pastaj çik më shpejt dhe pastaj akoma më shpejt.

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të ngjyrosi dy gjëra që shkojnë me njëra tjetrën në faqen 66.

Dita 4

Ju duhet:

- Gjëra të përditshme,
- Lapsa me ngjyrë.

Fëmija juaj mëson:

- të bëjë muzikë me gjëra të përditshme,
- të jetë kreativ dhe të krijojë gjëra me ato.

Detyra:

- Lëreni fëmijën tuaj të bëjë muzikë me instrumete, si për shëmbull një lugë të vogël, kapakun e tiganit, një krëhër si fyell, një filzhan të kthyer së prapthi si daulle e kështu me radhë.
- Krijoni me fëmijën tuaj instrumente muzike, për shëmbull prej kanoçeve, shisheve, tasa kosi, oris, bizeleve, e kështu me radhë.

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të numurojë sa lodra janë në faqen 67 dhe pastaj të ngjyrosi po aq rathe.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 68 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra.

Fëmija juaj mëson:

fjalët *poshtë*, *sipër*, *përpara*, *mbrapa* dhe *anash*.

Detyra:

- Prisini me fëmijën tuaj kartat në faqen 68 gjatë vizave të ndërprera. Vëri kartat së prapthi në tavolinë dhe përzjejini ato. Çdo lojtar tërheq si mbas radhës një kartë, thotë emrin e pozicionit të topit dhe duhet ta bëjë veprimin në kartë.

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të shikojë vëndin e lodrave, t'ju thotë emrin lodrave të ndryshme dhe të thotë cilat lëvizje mundet të behën me një lodër, për shëmbull të rëshkasësh, të lëkundesh, të tundesh e kështu me radhë.

JAVA 2: LËVIZJA

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 69 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra.

Fëmija juaj mëson:

ngjyrat,
forma dhe lëvizje të ndryshme.

Detyra:

- Flisni me fëmijën tuaj për figurën në faqen 69 dhe bëni pyetje për të:
 - “Çfarë po bëjnë fëmijët në figurë?”
 - “Ku janë fëmijët?”
 - “Sie quhen lodrat?”
 - “Sa fëmijë janë në tundëse?” (karusel, rëshkitse, lëkundëse), lëreni fëmijën tuaj të përgjigjet me fjali të plota, për shëmbull “Tre fëmijë janë në rëshkitësja”.
- Lëreni fëmijën tuaj ti ngjyrosi lodrat e ndryshme me ngjyra të ndryshme në faqen 69.

Detyrë shtesë:

- Këndoni me fëmijën tuaj këngën “Es tanzt ein Butzemann” (“Po kërcen një Xhuxh”).

LIED “Es tanzt ein Butzemann”

Es tanzt ein Bi-Ba-Butzemann
in unserem Haus herum, bidebum
Es tanzt ein Bi-Ba-Butzemann
in unserem Haus herum, bidebum
Er rüttelt sich, er schüttelt sich,
er wirft sein Säcklein hinter sich.
Es tanzt ein Bi-Ba-Butzemann in unserem Haus herum.

Es tanzt ein Bi-Ba-Butzemann
in unserem Haus herum, bidebum
es tantzt ein Bi-Ba-Butzemann
in unserem Haus herum, bidebum
Er wirft sein Säcklein her und hin,
Was ist wohl in dem Säcklein drinn?
Es tantzt ein Bi-Ba Butzemann in unserem Haus herum.

Këngë "Po kërcen një Xhuxh"

Po kërcen një Bi-Ba-Xhuxh
në shtëpinë tonë, bidebum
Po kërcen një Bi-Ba-Xhuxh
në shtëpinë tonë, bidebum
Ai rutullohet dhe tundet,
ai hedh qesen e vogël të tij mbrapa kurizit.
Po kërcen një Bi-Ba-Xhuxh në shtëpinë tonë.

Po kërcen një Bi-Ba-Xhuxh
në shtëpinë tonë, bidebum
Po kërcen një Bi-Ba-Xhuxh
në shtëpinë tonë, bidebum
Ai hedh qesen e vogël të tij sa këtej andej,
çfarë ka qeska e vogël e tij brënda?
Po kërcen një Bi-Ba-Xhuxh në shtëpinë tonë.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit.)

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 70 e fletëve të ushtrimeve,
- Një zar.

Fëmija juaj mëson:

Të numurojë nga 1 gjeri në 6.

Detyra:

- Vini një pikë fillimi dhe një pikë fundi në shtëpijën tuaj ose përjashta. Ju hidhni zarin njëri mbas tjetrit dhe bëni aq hapa sa numri i zarit tregon. Kush e arin fundin i pari, ka fituar lojën.
- Lëreni fëmijën tuaj ti numurojë gjërat në faqen 70 dhe të vizatojë po aq spirale në kutinë anash.

Dita 4

Ju duhet:

- Faqia 70 e fletëve të ushtrimeve,
- Ngjitës,
- Një gërshërë,
- Lapsa me ngjyrë,
- Një copë kartoni,
- Muzikë.

Fëmija juaj mëson:

të ndërtojë vetë një zarë,

të ushtrojë lëvizjet motorike fine dhe aftësin e reagimit të tij.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj ti ngjyrosi fushat me lëvizjet e ndryshme në faqen 71. Pastaj lëreni ta presi skicën e zarit me gërshërën dhe ta ngjisi skicën mbi kartonin. Tani sëbashku paloseni zarin gjatë vizave të ndërprera nga brënda dhe ngjitini fushat me vizat bashkë me njëra tjetrën.
- Lozni me fëmijën tuaj “lojën e lëvizjes” me zarin e sapo ndërtuar: Vini muzikë dhe lëreni fëmijën tuaj ta hedhi zarin. Përsëriteni që të dy lëvizjen që tregon zari disa herë. Ndëroni radhën dhe hidhni prapë zarin.

Dita 5

Fëmija juaj mëson:

të njohi aktivitetin e kohës.

Detyra:

- Flisni bashkë si kaloji dita e sotshme: Cila ditë e javës është sot? Cila ditë e javës është nesër?
- Luani me fëmijën tuaj lojën e gishtave.

FINGERSPIEL

Am Montag fängt die Woche an,
dann ist auch schon der Dienstag dran
am Mittwoch geht die Woche weiter,
der Donnerstag wird auch recht heiter,
am Freitag kommt das Wochenend',
am Samstag wird schön lang gepennt,
der letzte Tag ist Sonntag.

(mit 7 Fingern die Wochentagnamen mitzählen)

LOJA E GISHTAVE

Të hënën fillon java,
pastaj e ka radhën menjëherë e marta
të mërkurën java vazhdon,
dhe e enjtja është boll e qeshur,
të premten vjen fundi i javës,
të shtunën flihet shumë gjatë,
dita e fundit është e djela.

(numuroni met 7 gishta ditët e javës)

- Diskutoni bashkë me fëmijën tuaj planet për ditën e nesërme.

Detyrë shtesë:

- Luani bashkë me fëmijën tuaj lojën me zarin nga dita e djeshme.

JAVA 3: LËVIZJA

Dita 1

Ju duhet:

- Faqia 72 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra,

Fëmija juaj mëson:

të flasi për ndjenja si kënaqësi, mërzi dhe nervozim

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për figurën në faqen 72, për shëmbull:
 - “Pse po zihen fëmijët?”
 - “Ku po lozin fëmijët?”

Detyra shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të numërojë gishtat e duarve dhe të këmbëvje kur është duke u larë.
- Lexohini vjershën fëmijës tuaj dhe përsëriteni atë disa herë bashkë.

GEDICHT

Am Sonntag scheint die Sonne.
Am Montag kommt der Herr Mon.
Am Dienstag hat er Dienst.
Am Mittwoch ist die Mitte der Woche.
Am Donnerstag donnert es.
Am Feiertag hat er frei.
Am Samstag kommt das Sams.

VJERSHË

Të djelën shkëlqen djelli.
Të hënë vjen zoti Mon.
Të martën ai punon.
Të mërkurën është mesi i javës.
Të enjten bije shi.
Të premten ai e ka pushim.
Të shtunën vjen Samsi.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit.)



Detyra shtesë:

Ju duhet:

- Dy spango ose litare që janë minimumi një metër të gjatë dhe dy shkopa (aq të mdhenj sa një laps),

Fëmija juaj mëson:

të ushtrijet lëvizjet kryesore motorike e tij,
të lidhi të folurën me levizje.

- Njëra nga spangot lidhet me një shkop. I thoni fëmijës tuaj të bejë lëvizje si një reth me shkopin. Nëqoftse fëmija juaj e bën këtë në rregull, lëroni ti bejë rathët me dy shkopa. Fëmija juaj mundet të provojë dhe levizje të tjera, për shëmbull si një gjarpër.

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 73 e fletëve të ushtrimeve,
- Kopsa ose ruaza me madhësi të ndryshme,
- Kopsa që duken ndryshe nga njëra tjetra.

Fëmija juaj mëson:

të gjejë ndryshimet dhe gjërat e përbashkta.
fjalët *e madhe* dhe *më e madhe*, *e vogël* dhe *më e vogël*, *e lemuar* dhe *e ashpër*, *e erët* dhe *e hapur*.

Detyrat:

- Jepini fëmijës tuaj detyra si mbas kopsave, për shëmbull:
 - Kërko kopsa që kanë të njëjtën madhësi.
 - Kërko një kopsë që është më e vogël se sa kjo.
 - Kërko një kopsë blu.
 - Kërko një kopsë me dy vrima.
- Lëroni fëmijën tuaj të tërheqi viza midis dy kopsave që janë njësoj në faqen 73.

Detyra shtesë:

- Lëroni fëmijën tuaj të krijojë një lojë me kopsa.
- Lëroni fëmijën tuaj ti kalojë kopsat me një gjylypërë në një spango ose fije leshi, për shëmbull si varse dore ose qafe.

- Lëreni fëmijën tuaj të numurojë sa kopsa ka veshja e tij.

Dita 4

Ju duhet:

- Letër prej gazetave,
- Një gërshërë,
- Muzik kërcimi.

Fëmija juaj mëson:

të përqëndrohet,
të reagojë tamam mbas një ngjarje,
format e *rethit*, *trekëndshit*, *katror* dhe të *katërkëndshit*.

Detyra:

- Prisni me fëmijën tuaj prej letrave të gazetës një reth të madh, një katror, një trekëndsh dhe një katërkëndsh. Shpërdajini këto forma në për dhomë. Vini muzikë kërcimi: Fëmija juaj levizën si mbas muzikës në dhomë. Ndaloheni muzikën dhe jepini fëmijës tuaj një detyrë. Pastaj lëreni muzikën të vazhdojë, ndaloheni prap dhe jepini një detyrë të re e kështu me radhë. Detyrat mundet të jenë për shëmbull: “Shko ri mbi rethin”, “Hec reth katërkëndshit”, “Kërce me një këmbë mbi trekëndshin” e kështu me radhë.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqia 74 e fletëve të ushtrimeve,

Fëmija juaj mëson:

t’ju thotë emrin pjesve të ndryshme të fytyrës, për shëmbull faqet, mjekra, dhëmbët, vetullat, qerpikët, një vjershë.

Detyra:

- Dilni me fëmijën tuaj para një pasqyre dhe tregoni këto pjesë të trupit:
 - faqet e mija, faqet e tua,
 - mjekra ime, mjekra jote,
 - qerpikët e mi, qerpikët e tu,

- e kështu me radhë,
- Provoni me fëmijën tuaj lëvizje të ndryshme të fytyrës: të rudhosësh ballin, të ngresh vetullat, të përplasësh qerpikët, një fytyrë të kënaqur, të nxierësh gjuhën, e kështu me radhë.
- Lëreni fëmijën tuaj të vizatojë një fytyrë me aq shume detaje sa ai mundet në faqen 74.
- Lexohini fëmijës tuaj këtë vjershë dhe përseriteni bashkë disa herë.

GEDICHT

Das sind meine Wangen
das ist mein Kinn,
das ist mein Mund,
mit Zähnen drin.
Das sind meine Ohren,
meine Augen, meine Nase,
Das ist doch wohl klar.

VJERSHË

Këto janë faqet e mija,
kjo është mjekra ime,
kjo është goja ime,
me dhëmbët brënda.
Këto janë veshët e mia,
sytë e mia, hunda ime,
kjo ama është e qartë.

Detyra shitesë:

- Bëjini fëmijës tuaj “pyetje koti” si për shëmbull:
 - “Është kjo hunda ime?” (Tregoni tek një vesh)
 - “Jam duke fluturuar unë?” (Uluni në tokë)
 - e kështu me radhë.
- Lëreni fëmijën tuaj në të njëjtën mënyrë të bëjë pyetje për të qeshur.

Në Shtëpi



Në shtëpi është një temë për të cilën nuk ka shumë nevojë për oragnizim. Shumica e njerëzve banojnë në një shtëpi. Dhe për këtë temë nuk ka vënd më të mirë se 4 muret e veta.

Zbuloni me fëmijën tuaj dhomat e ndryshme të shtëpisë:

- dhomën e ndënjës,
- dhomën e fëmijës,
- guzhinën,
- banjën,
- dhomën e gjumit.

Ju mundet të flisni dhe për mobiljet dhe paisjet e dhomave të ndryshme. Ju mundet të diskutoni për çfarë duhen këto dhoma. Shikoni sëbashku muret dhe dritaret, si nga brënda ashtu dhe nga përjashta.

Shikoni dhe shtëpi të tjera kur jeni në rugë. Do vini re që ka shumë gjëra të përbashkta midis shtëpive, por dhe shumë gjëra të ndryshme. Çatitë mundet të jenë të ndryshme, disa shtëpi kanë një baçe, disa shtëpi kanë më shumë kate. Ka edhe shtëpi me më shumë se 20 kate.

Jo të tërë njerëzit jetojnë në shtëpi. Dhe sot jetojnë disa endacakë për shëmbull në çadra dhe disa Inuit në shtëpi prej dëbore dhe princat dhe princesat jetonin më përpara në kështjella.

Prej lloje të ndryshme kutish ju bashkë me fëmijën tuaj mundet të ndërtoni shtëpi.
Me shumë kuti ju mund të ndërtoni një qytet të tërë me ruge dhe parqe lodrash.

Ju urojmë shumë qef duke ndërtuar!

J A V A 1: N Ë S H T Ë P I

Dita 1

Ju duhet:

- Faqet 76 dhe 77 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë.

Fëmija juaj mëson:

- të shikojë tamam,
- të medohet për gjërat rreth tij.

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për figurën në faqen 76. Ju mundet të bëni pyetje, për shëmbull:
 - Në cilën dhomë është fëmija?
 - Çfarë po bën fëmija?
 - Sa mundet të jetë ora?
 - Kur shkon ti për të fjetur?
 - Si duket dhoma jote?
 - Ke dhe ti panorama në dhomën tënde?
- Shokni me fëmijën tuaj në dhomën e gjumit dhe jepini njëri tjetrit detyra të ndryshme, për shëmbull:
 - Ulu në krevatin tënd.
 - Shtriu poshtë krevatit tënd.
 - Çfarë ka dollapi?
 - Çfarë është varur në mur?
 - Shko ri në cep të krevatit tënd.
 - e kështu me radhë.
- Lëreni fëmijën tuaj ti ndjeki vizat në faqen 65 dhe të gjejë me çfarë po loz djali.

Detyra shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të vizatojë një shtëpi në faqen 77, në të cilën ai to deshte të banonte.
- Flisni me fëmijën tuaj për ditët e javës, për shëmbull:
 - Cila ditë është sot?
 - Cila ditë ishte dje?

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit)

Dita 3

Ju duhet:

- Faqia 78 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyrë,
- Një kuti më këto gjera: Një lugë prej druri, një gur, një shami, një lugë plastike dhe një gotë plastike, një filxhan çaji.

Fëmija juaj mëson:

karakteristikat e materialeve të ndryshme.

Detyrat:

- Hapni një vrimë në kuti, aq të madhe sa mundet të futet dora, ose vini një picet mbi kuti. (E rëndësishme është që fëmija juaj vetëm ti preiki gjërat, por të mos i shikojë ato.)
Rekomandim: Ruheni këtë kuti!
- Shëmbuj për detyra:
 - Lëreni fëmijën tuaj të kërkojë shaminë.
 - Lëreni fëmijën tuaj të kërkojë diçka që është e fortë.
 - Lëreni fëmijën tuaj të kërkojë diçka që është e fortë dhe e ftotë.
 - Lëreni fëmijën tuaj të nxjeri diçka nga kutia dhe të thotë nëqoftse ajo është e ftotë ose e ngrohtë. Është e fortë ose e butë?
 - Lëreni fëmijën tuaj të nxjeri diçka nga kutia dhe të tregojë diçka për atë gjë.
 - e kështu me radhë.
- Lëreni fëmijën tuaj të bejë një vizë në faqen 78 nga banesa deri tek materiali nga i cili ajo është ndërtuar.

Detyrë shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të ngjyrosi dy gjëra që shkojnë me njëra tjetrën në faqen 66.

Dita 4

Fëmija juaj mëson:
ndarjen e ditës.

Detyra:

- Flisni me fëmijën tuaj për ndarjen e ditës, për shëmbull:
 - Çfarë bën ti në mëngjes?
 - Je ti në drekë në shtëpi?
 - Ku je ti në darkë?

Dita 5

Ju duhet:

- një kuti,
- kanoçe të vogla,
- disa topa letër higjenike
- shkopa të vegjël (prej druri)
- letër,
- revista,
- një gërshërë,
- ngjitës.

Fëmija juaj mëson:
të presi dhe të ngjisi gjëra tamam,
të vlerësojë përafërsisht sa e madhe është diçka.

Detyra:

- Ndërtoni bashkë me fëmijën tuaj një dhomë gjumi në kuti. (Kjo mundet të jetë një kuti për tu parë, ose një pjesë e një shtëpije kukullash.)

Detyra shtesë:

- Flisni me fëmijën tuaj për qytete të mëdha, fshatra të vogla, rugët dhe shtëpitë e ndryshme. (për shëmbull një makinështëpi, një çadër, një varkështëpi, një shtëpi fshati, një kasolle, një gradaçielë, një shtëpi debore, e kështu me radhë.)
- Këndoni bashkë me fëmijën tuaj një këngë gjumi.

JAVA 2: NË SHTËPI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqet 79 dhe 80 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra,
- Një gërsërë.

Fëmija juaj mëson:

të mëndojë në mënyrë logjike,
ndryshimin midis ditës dhe natës.

Detyra:

- Lëreni fëmijën tuaj të shikojë figurën në faqen 79 dhe të flasi për ndryshimet.
- Prisni figurat në faqen 80 ose lëreni fëmijën tuaj ti presi aso. Tre figura shkojnë gjithmonë bashkë. Tregoni për këto tre figura një përallë, për shëmbull:
 - Këtu ti shikon duar të pista, dhe këtu ti shikon duar të pastra, çfarë ka ndodhur këtu?
 - Këtu ti shikon një fëmijë të pistë dhe këtu ti shikon një fëmijë në banjerë, cila figurë vjen tani?
 - Këtu ti shikon filxhane të pista dhe atje një lavaman, çfarë do ndodhi?

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri-tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit.)

Dita 3

Ju duhet:

- Një kuti me materiale formimi të ndryshme,
- Një gërsërë,
- Ngjitës,
- Një foto të një ruge me shtëpi (ruga juaj, në të cilën ju banoni do ishte shëmbulli më i mirë)

- Një fotografi nga dhoma e ndënjes

Fëmija juaj mëson:

të presi dhe të ngjisi tamam,
të përshkruaj të vërtetën.

Detyra:

- Flisni me fëmijën tuaj për fotografitë, për shëmbull:
 - Çfarë shikon ti në fotografi?
 - Kush banon atje?
 - Ku banojnë komshinjtë tanë?
 - Më trego dollapin në fotografi.
- Lëreni fëmijën tuaj ta ndërtojë dhomën e ndënjes prej materialeve të ndryshme dhe të tregojë diçka për të.

Dita 4

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për dhomat e ndryshme të shtëpisë dhe për çfarë mundet të bëhet në këto dhoma.
- Lëreni fëmijën tuaj të preki materiale të ndryshme përjashta, për shëmbull një gur, një dritare prej druri, një biçikletë prej metali e kështu me radhë.
- Lozni bashkë me fëmijën tuaj prapë me kutin nga dita e tretë e javës së parë.

Dita 5

Ju duhet:

- Faqet 81 dhe 82 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra,
- Një laps i zi.

Fëmija juaj mëson:

të kujdeset për ndryshimet,
të dallojë gjëra që mundet të lëvizin.

Detyra:

- Lëreni fëmijën tuaj të vizatojë detajet që mungojnë në faqen 81.

- Lëreni fëmijën tuaj t'ju thotë emrin gjërave në faqen 82 dhe të ngjyrosi vetëm ato që mundet të lëvizin.

Detyra shtesë:

- Lëreni fëmijën tuaj të ndërtojë një dhomë të re për shtëpinë e kukullave.
- Regulloni shtëpinë bashkë me fëmijën tuaj dhe flisni për gjërat që ju dallin përpara gjatë kësaj.

JAVA 3: NË SHTËPI

Dita 1

Ju duhet:

- Faqet 83 dhe 84 e fletëve të ushtrimeve,
- Lapsa me ngjyra,
- Një gërsërë.

Fëmija juaj mëson:

të flasi për ndjenjat e tij.

Detyrat:

- Lëreni fëmijën tuaj të flasi për figurën në faqen 83, për shëmbull:
 - Kur qan një fëmijë dhe kur qan ti?
 - Pse qan ti pastaj?
 - Çfarë bën edukatori/edukatorja në kopësht kur ti qan?
 - Qan ti vetëm kur ke frikë ose dhe kur je me nerva?
- Lëreni fëmijën tuaj të bëjë sikur është i mërzitur dhe po e ngushillon dikush.
- Pritini figurat në faqen 84, ose lëreni fëmijën tuaj ti presi ato, dhe lëreni fëmijën tuaj të flasi për ato.
- Lëreni fëmijën tuaj ti ndajë figurat në dy grupe, ato që e bëjnë atë të gëzuar, dhe ato që e bëjnë atë të mërzitur.

Detyra shtesë:

- Tregojini fëmijës tuaj çfarë ju gëzon juve dhe për çfarë ju jeni gëzuar kur ishit fëmijë.
- Flisni bashkë me fëmijën tuaj në bazë të figurave nga faqia 84 për kujtimet që ju të dy keni.
- Ndroni gjërat që janë brënda në kutinë nga dita e tretë e javës së parë dhe lëreni fëmijën tuaj të gjejë çfarë ajo ka brënda.

Dita 2

Detyra:

- Lexoni bashkë një libër dhe flisni me njëri tjetrin për të. (Kini parasysh dhe udhëzimet e librit.)

Dita 3

Ju duhet:

- Faqet 83 dhe 84 e fletëve të ushtrimeve,
- Një shami,
- Një lugë,
- Një sapun,
- Një mollë,
- Një gërshtë,
- Ngjitës.

Fëmija juaj mëson:

të rendisi gjërat,
të presi ekzakt.

Detyrat:

- Flisni me fëmijën tuaj për gjërat dhe lëreni atë të përshkruajë se çfarë ndjen kur i prek ato.
- Lutjuni fëmijës tuaj ti vëri gjërat prapë në vëndin e tyre, njëra mbas tjetrës. (mundet dhe të lozni “Lojën-Ftohtë-Ngrohtë” gjatë kësaj.)
- Lëreni fëmijën tuaj ti presi figurat në faqet 85 dhe 86 dhe ti ngjisi ato atje ku e kanë vëndin.

Detyra shtesë:

- Rimoni bashkë me fëmijën tuaj ose lëreni fëmijën tuaj të rimojë vetë me këto fjalë:

- Haus...	Shëtpi...
- Mond...	Hënë...
- Seil...	Litar...
- Fenster...	Dritare...
- Zelt...	Çadr...
- wohnen...	të banosh...

Dita 4

Ju duhet:

- Faqja 87 e fletëve të ushtrimeve,

Detyra:

- Lëreni fëmijën tuaj të flasi për foletë e kafshëve, që ai shikon në faqen 87.
- Këndoni më fëmijën tuaj këngën:

LIED

